



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 124 Akti

Nr. 195 Vendimi
Tiranë, më 9.9.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, në datën 4 shtator 2019, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Hysni Vata**, prokuror/drejtuës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, z. Hysni Vata, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 4.9.2019, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Hysni Vata, për shkak të funksionit si prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.

2. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 1 – i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Lulzim Hamitaj dhe Firdes Shuli – pasi administroi dhe studioi tri raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 20.3.2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, znj. Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

3. Më pas, për arsye objektive pamundësie, në bazë të vendimit nr. 40, datë 16.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e dosjeve të çështjeve të komisionerit Alma Faskaj”, nëpërmjet procedurës së shortit, anëtarja e trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj, u zëvendësua nga komisionere Pamela Qirko.

4. Në vijim të hapave hetimorë, në datën 1.7.2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për z. Hysni Vata të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht, në kontrollin e pasurisë, të figurës dhe në atë profesional.

5. Në datën 3.7.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 18.6.2019; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

6. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe mori kopje, ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet e veta në Komision, në datën 18 korrik, së bashku me një kërkesë për të dëgjuar disa persona si dëshmitarë. Trupi gjykues, pasi e shqyrtoi dhe e vlerësoi kërkesën në fjalë, vendosi që të mos e pranojë atë, në bazë të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga njëra anë, pothuajse të gjithë personat e kërkuar për t’u dëgjuar i kishin shprehur qëndrimet dhe dijenitë e tyre në lidhje faktet për t’u provuar dhe, nga ana tjetër, edhe sikur dëshmitarët të

¹ Paragrafi 3, i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “*Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio*”.

konfirmonin versionin e fakteve të shpjeguara më herët nga subjekti (mbi punësimin dhe fitimet e vëllait të subjektit, z. M. V., në Greqi), nuk do të mjaftonte prova me dëshmitarë për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të vëllait – në cilësinë e huadhënësit – i cili (në sajë të shpjegimeve të vetë subjektit), nuk rezultonte të kishte jetuar, asokohe, me leje qëndrimi në shtetin grek dhe, rrjedhimisht, nuk kishte punuar i regjistruar edhe me pagesat e detyrimeve tatimore dhe kontributeve për sigurimet shoqërore që do të pasonin. Për rrjedhojë, provat e kërkuara u vlerësuan nga trupi gjykues si të parëndësishme dhe të panevojshme për vendimmarrjen.

7. Në datën 19 korrik, Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit që të paraqitej në seancën dëgjimore, të parashikuar për në datën 23.7.2019, por z. Hysni Vata, në të njëjtën datë, ka kërkuar shtyrjen e seancës, duke bërë më dije se ishte nën trajtim mjekësor spitalor, dhe se në datën 22 korrik do të përcillte pranë Komisionit raportin mjekësor përkatës.

8. Në datën 22 korrik, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit për shtyrjen e seancës për arsye shëndetësore, si dhe raportin mjekësor – që parashikonte një paaftësi për punë të z. Hysni Vata, deri më 1.8.2019 – vendosi shtyrjen e datës së seancës.

9. Në datën 30 korrik, Komisioni ka njoftuar në rrugë elektronike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, datën e re për seancën dëgjimore, të caktuar për më 4.9.2019, datë në të cilën ajo u zhvillua rregullisht, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent – pa përfaqësues – dhe paraqiti shpjegimet dhe argumentimet e veta.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore e datës 4.9.2019 – për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Vata – u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

11. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit – dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

12. Z. Hysni Vata, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e vet, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

13. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, si dhe shprehu qëndrimin e vet përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion kërkoi konfirmimin në detyrë.

14. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Vata, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

15. Seanca dëgjimore e datës 4.9.2019 u ndërpre, për të rifilluar në datën 9.9.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Z. Hysni Vata ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje sa herë është pyetur dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpjegimet e veta edhe në lidhje me burimet financiare të personave të tjerë me të cilët kishte pasur marrëdhënie financiare.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

17. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- i. provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, ‘Vetting’”;
- ii. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- iii. raportet dhe informacionet mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- iv. provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- v. deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;
- vi. shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë të bëra nga subjekti në seancën dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- vii. deklaratimet e personave të lidhur, apo të tjerë të lidhur;
- viii. faktet e njohura botërisht.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

18. Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2018, ka dërguar raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë e në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

20. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin

e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, në zbatim të ligjit nr. 84/2016

21. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. **Apartament² me sip. 70,9 m², me vlerë 1.565.392³ lekë**, në bashkëpronësi me bashkëshorten, e ndodhur në lagjen “****”, Burrel, Mat. Me nr. pasurie ***, z.k. nr. ***, vol. ***, f. ***. Burimi i krijimit, sipas deklaratës “Vetting” rezulton nga të ardhurat familjare (paga e subjektit dhe paga e bashkëshortes) ndër vite dhe dëmshpërblim⁴ për largim të padrejtë nga puna. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, burimi është deklaruar⁵ nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.
- ii. **Apartament me sip. 91,34 m², me vlerë 40.500 euro**, në posedim me bashkëshorten⁶, i ndodhur në Tiranë, me burim krijimi, nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes, si dhe të vëllait të subjektit⁷.
- iii. **Automjet tip “Peugeot”, blerë në vlerën 200.000 lekë**, në emër të vajzës së subjektit – G. V. – me burim krijimi nga kursimet familjare.
- iv. **Gjendje cash 1.400.000 lekë**, në bashkëpronësi me bashkëshorten.
- v. **Gjendje depozitë në “Credins Bank” në emër të bashkëshortes⁸ së subjektit, në vlerën 4.085.784,33 lekë**, si dhe gjendje depozitë në “Credins Bank”, në emër të vajzës së subjektit⁹, në vlerën 50.000 lekë, me burim krijimi¹⁰ të deklaruar nga kursimet dhe nga pagat e subjektit, si dhe nga të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes.

Vlerësimi i pasurisë

I - Apartament me sip. 70,9 m², me vlerë 1.565.392¹¹ lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, e ndodhur në lagjen “****”, Burrel, Mat, me nr. pasurie ***, z.k. nr. ***, vol. ***, f. ***. Lidhur me këtë pasuri, nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar sa përshkruhet më poshtë:

² Përfitur me kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 30.10.2013 të Dhomës së Noterisë, Tiranë.

³ Vlera sipas kontratës nr. ***, datë 26.11.2002 të Noterisë Mat, sipas kësaj kontrate, subjekti duhet të paguajë **295.090** lekë, pasi përfiton zbritje të çmimit të banesës, për apartamentin me nr. pasurie *** ndodhur në z.k. ***, Burrel, Mat.

⁴ Çek bankar (Banka e Kursimeve) me vlerë 372.600 lekë, më 29.1.2002.

⁵ Deklaruar në formularin e deklarimit në ILDKPKI në vitin 2006.

⁶ Përfitur sipas aktmarrëveshjes (kontratë porosie) nr. ***, datë 29.6.2007 me znj. F. V. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

⁷ Deklaruar në formularin e deklarimit në ILDKPKI për deklaratën “Vetting”.

⁸ F. V.

⁹ F. V.

¹⁰ Deklaruar në formularët e deklarimit periodik të pasurisë dhe në formularin “Vetting”.

¹¹ Vlera sipas kontratës nr. ***, datë 26.11.2002 të Noterisë Mat, sipas kësaj kontrate subjekti duhet të paguajë **295,090 (239.090+56.000)** lekë, pasi përfiton zbritje të çmimit të banesës, për apartamentin me nr. pasurie ***, ndodhur në z.k. ***, Burrel, Mat.

22. Subjekti ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri përmes kontratës së shkëmbimit të datës 30.10.2013, me apartamentin¹² me nr. pasurie ***, ndodhur në z.k. ***, Burrel, Mat, të cilin e ka blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, me kontratën e datës 17.8.1995.

23. Subjekti, në deklarinimin e vlerës së kësaj pasurie i është referuar çmimit të kontratës të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave, i cili fillimisht ishte në vlerën **1.565.392¹³ lekë**, por për shkak të parashikimeve ligjore subjekti ka përfituar zbritje të çmimit të pronës, dhe rrjedhimisht ka paguar vetëm shumën prej **295.090¹⁴ lekësh**.

24. Subjekti, me kontratën e shkëmbimi nr. ***, datë 30.10.2013, të Dhomës së Noterisë, Tiranë, ka fituar pronësinë mbi këtë apartament me sip. 70.9 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në lagjen “****”, Burrel.

25. Pasuria e mësipërme është shkëmbyer me pasurinë nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. *** me sip. 78.1 m², ndodhur në lagjen “****”, Burrel.

26. Pasuria nr. ***, e cila ka shërbyer për shkëmbimin, është blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nga Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Dibër me kontratën nr. ***, datë 26.11.2002, me çmimin total prej 295.090 lekësh, nga të cilat 56.000 lekë janë paguar në datën 21.8.1995.

27. Vlera e deklaruar në deklaratën “Vetting” për këtë pasuri është 1.565.392 lekë, por në deklaratën para fillimit të detyrës¹⁵ vlera e blerjes së apartamentit është deklaruar **530.000 lekë¹⁶**.

28. Burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting” është deklaruar nga shkëmbimi me një tjetër apartament – të blerë në vitin 2002 me të ardhurat familjare (paga e subjektit dhe paga e bashkëshortes) ndër vite. Në përgjigje të pyetësorëve është specifikuar/shtuar edhe burimi nga një dëmshpërblim¹⁷ për largim të padrejtë nga puna, i përfituar në janar të vitit 2002.

29. Në vitin 1995, subjekti ka parapaguar për blerjen e apartamentit shumën prej 56.000 lekësh. Të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes për vitin 1995, sipas vërtetimeve nga punëdhënësit, kanë qenë 461.139 lekë, ndërsa shpenzimet jetike rezultojnë 322.797¹⁸ lekë.

30. Duke konsideruar të dhënat më sipër $461.139 - (322.797 + 56.000) = 82.342$ lekë, vërtetohet se subjekti ka pasur mundësi të bëjë këtë pagesë. Sipas dokumenteve të administruara – kontrata e shitblerjes dhe mandati i bankës – rezulton se subjekti, në datën 25.11.2002, ka paguar shumën prej 239.000 lekësh për blerjen e pasurisë nr. ***.

31. Subjekti – në bazë të një vendimi gjykate mbi dëmshpërblimin për largimin e tij të padrejtë nga puna, më 29.1.2002 – ka përfituar një çek bankar (vlera e dëmshpërblimit) me vlerë

¹² Për këtë apartament subjekti, në deklarinimin fillestar para fillimit të detyrës në vitin 2006, deklaroi se e ka përfituar nga EKB në vitin 1994, ndërkohë që, nga kontrata e përkohshme e shitjes, datë 17.8.1995 evidentohet që ky apartament do të ndërtohet pas nënshkrimit të kësaj kontrate paraprake.

¹³ Subjekti në deklarinimin para fillimit të detyrës në vitin 2006, deklaroi si vlerë **530.000** lekë, por nuk është e qartë se nga vjen kjo vlerë.

¹⁴ Paguar shuma **239.090** lekë në vitin 2002, sipas kontratës dhe mandatit të bankës.

¹⁵ Deklaruar më 14.12.2006

¹⁶ Në pyetësorin nr. 3, datë 8.4.2019, subjekti ka shpjeguar se në deklarinimin fillestar është bërë një gabim në deklarim duke deklaruar vetëm vlerën fillestare, kështu e parë, të paguar për këtë apartament dhe shuma është shënuar me lekë të vjetra. Vlera fillestare e paguar ka qenë 56.000 lekë.

¹⁷ Çek bankar (Banka e Kursimeve) me vlerë 372.600 lekë, 29.1.2002.

¹⁸ Përllogaritur si 70% e të ardhurave të gjeneruara nga subjekti dhe bashkëshortja për këtë vit.

372.600 lekë. Ndërkohë që, të ardhurat e bashkëshortes së subjektit për vitin 2002, kanë qenë 578.632 lekë.

32. Shpenzimet jetike për vitin 2002, nga analiza e njësisë ligjore, kanë rezultuar në shumën 401.924 lekë¹⁹.

33. Rezultatet e mësipërme i janë njoftuar subjektit të rivlerësimit, së bashku me konkluzionet e arritura lidhur me këtë pasuri, të cilat konsistojnë në: *i. subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme; ii. ka mospërputhje midis deklaratës para fillimit të detyrës dhe kontratës së shitblerjes, lidhur me vlerën e deklaruar të kësaj pasurie; iii. subjekti nuk ka deklaruar në vitin 2013 shkëmbimin e pasurisë së tij – me një tjetër apartament – të kryer sipas kontratës nr. ***, datë 30.10.2013.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me rezultatet e arritura nga Komisioni mbi pasurinë e analizuar më lart, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si më poshtë:

34. Këtë pasuri e ka përfutur me statusin e të pastrehut, dhe se vlera në kontratën e blerjes së saj është përshkruar në shumën prej 1.565.392 lekësh, por duke qenë se apartamenti në fjalë është përfutur me statusin e të pastrehut, janë paguar vetëm dy këste: kësti i parë në vlerën 56.000 lekë dhe kësti i dytë në vlerën 239.090 lekë. Vlera në total është 295.090 lekë, ndërsa vlera e deklaruar në deklaratën “Vetting”, prej 1.565.392 lekësh, është sipas kontratës së shitjes. Në pyetësorët e nisur nga Komisioni, subjekti ka dhënë sqarime mbi pagesat e kryera.

35. Në lidhje me ndryshimin në deklarimin fillestar subjekti ka sqaruar se gabimisht ka vendosur vlerën e pagesës fillestare, duke e shprehur atë me lekë të vjetra (me një shifër më shumë).

36. Për sa i përket shkëmbimit të pasurive, subjekti – ashtu sikundër në përgjigjet e dhëna në pyetësor – sqaron se shkëmbimi faktik i këtyre pasurive ka ndodhur në vitin 1996 dhe vetëm *de jure* është finalizuar në vitin 2013. Subjekti ka pohuar se duke qenë se nuk ka pasur detyrime të ndërsjella mes palëve, duke qenë një marrëdhënie midis familjarëve (pasi shkëmbimi është realizuar me prindërit e vet), nuk është vlerësuar e nevojshme që të deklarohet, dhe se nuk ka pasur synim ndonjë fshehje.

Vlerësimi i Komisionit

37. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Mospërputhjet midis deklarimeve të ndryshme lidhur me vlerën e apartamentit dhe mosdeklarimi nga ana e subjektit të shkëmbimit të apartamentit me prindërit e vet, përbëjnë pasaktësi në deklaratet vjetore, të cilat do të çmohen për peshën e tyre specifike, në një vlerësim tërësor të çështjes në fjalë.

II - Apartament me sip. 91,34 m², me vlerë 40.500 euro, në Tiranë

38. Nga hetimi administrative i Komisionit, kjo pasuri rezultoi të jetë në bashkëposedim të subjektit me bashkëshorten²⁰. Subjekti ende nuk rezulton të ketë titullin/certifikatën e pronësisë për këtë pronë, pasi marrëdhëniet me shoqërinë ndërtuese është rregulluar sipas aktmarrëveshjes

¹⁹ Të përllogaritura sipas referencave të shkresës së ILDKPKI-së, Nr. *** Prot., datë 04.03.2019.

²⁰ Përfutur sipas aktmarrëveshjes (kontratë porosie) nr. ***, datë 29.6.2007 me znj. F. V. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

(kontratë porosie) nr. ***, datë 29.6.2007, të nënshkruar midis znj. F. V. (bashkëshortja e subjektit) dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

39. Vlera e kësaj pasurie në kontratë rezulton të jetë 40.500 euro, nga e cila janë likuiduar vetëm 38.500 euro²¹, sipas parashikimeve kontraktore dhe mandatpagesave, të konfirmuara edhe nga deklaratat e shoqërisë ndërtuese e datës 26.1.2017.

40. Lidhur me burimet e krijimit për këtë pasuri rezulton se, në deklaratën “Vetting” është përshkruar: nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes së tij, si dhe nga kursimet e të vëllait të subjektit, të ndodhura në “Societe Generale Bank”, në vlerën 4.100.000 lekë.

41. Në deklaratën e vitit 2007, subjekti ka deklaruar prenotim të një apartamenti me vlerë 41.000 euro, nga e cila janë paguar 33.250 euro dhe se për këtë pagesë është përdorur depozita që ndodhej në “Bankën Popullore”, në shumën prej 4.100.000 lekësh.

42. Në kuadër të këtij rivlerësimi u mor në analizë pikërisht depozita prej **4.100.000** lekësh – e cila ishte përdorur dhe deklaruar nga subjekti si burim për financimin e kësaj pasurie – nga ku rezultoi se:

42.1 Në deklarimin para fillimit të detyrës më datë 14.12.2006, subjekti ka deklaruar depozitë prej 4.100.000 lekësh në “Bankën Popullore”, duke specifikuar se nga kjo shumë e depozituar, pjesa prej 3.600.000 lekësh ishin të vëllait të vet – z. M. V. – dhe se vetëm diferenca prej 500.000 lekësh i përkiste familjes së subjektit.

42.2 Sipas dokumenteve të administruara nga banka rezulton që llogaria e depozitës në fjalë ka qenë dyemërore: në emër të znj. F. V. (bashkëshortja e subjektit) dhe të z. M. V. (vëllai i subjektit).

42.3 Gjithashtu, nga dokumentet bankare evidentohet që të gjitha shumet e derdhura në bankë janë depozituar në *cash* nga znj. F. V.²² dhe nuk rezultojnë veprime të kryera nga z. M. V.

42.4 Në pyetësorin nr. 2, datë 4.3.2019 dhe në pyetësorin nr. 3, datë 8.4.2019, subjekti – pasi është pyetur në lidhje me marrëdhënien financiare me të vëllain dhe mbi burimin e të ardhurave të tij, për shumën prej 3,6 milionë lekësh – është përgjigjur se *z. M. V. ka qenë emigrant, fillimisht në Greqi, e më pas në Spanjë dhe ka punuar pa dokumente, për pasojë, nuk mund të provojë me dokumente burimin e këtyre të ardhurave*. Gjithashtu, subjekti sqaron të ketë marrë në vitin 2009 një kredi në shumën 3.000.000 lekë për të shlyer këtë detyrim dhe që nga ky vit ai nuk ka pasur më detyrime ndaj të vëllait²³.

42.5 Subjekti i ka bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 tri deklaratat²⁴ noteriale të shtetasve Dh., V. dhe F. V., të cilët shprehen se kanë punuar së bashku me z. M. V., në kohën që ai ka qenë emigrant në Greqi.

42.6 Gjithashtu, z. F. V. – djali i xhaxhait të subjektit - shprehet se: *“Në maj të vitit 2003 i kam dhënë z. M. V. 17.500 euro, të cilat m’i ka kthyer e nuk kam pretendime ndaj tij”*.

43. Në vitin 2009 rezulton se subjekti ka marrë një kredi bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 3.000.000 lekë, shumë e disbursuar nga banka në datën 12.5.2009, nga e cila në datën 14.5.2009 është tërhequr *cash* shuma prej 2.730.000 lekësh.

²¹ Sipas vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., datë 26.1.2017 në dosjen e ILDKPKI-së.

²² Përkatesisht: 2.000.000 lekë në datën 3.4.2006 dhe 2.100.000 lekë në datën 29.6.2006.

²³ Shpenzim/veprim financiar i padeklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2009. Nga viti 2007 deri në vitin 2008 nuk është deklaruar detyrimi që subjekti mbarte ndaj vëllait.

²⁴ Të hartuara më 3, 4 dhe 5 prill të vitit 2019.

44. Në pyetësonin nr. 2, datë 4.3.2019, subjekti është shprehur se shuma e përfituar nga kjo kredi është përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj të vëllait, M. V., ndërkohë që në deklarinin periodik vjetor për vitin 2009, nuk rezulton që të jetë deklaruar pagesa e kësaj shume si shpenzim dhe pakësimi i këtij detyrimi.

45. Gjithashtu, në deklarimet periodike vjetore për vitet 2007 dhe 2008 nuk rezulton të jetë deklaruar në rubrikën përkatëse, si detyrim i mbartur ndaj të tretëve, ekzistenca e këtij detyrimi.

46. Lidhur me këtë pasuri dhe mbi deklarimet përkatëse, Komisioni i ka njoftuar subjektin gjetjet e mësipërme, si dhe i është kaluar barra e provës për konkluzionet e mëposhtme: *i. Duket se subjekti i rivlerësimit nuk²⁵ ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, pasi mbetet e paprovuar me dokumente ligjor, burimi i ligjshëm për shumën prej 3.600.000 lekësh – që sipas subjektit është gjeneruar nga puna e vëllait të tij – z. M. V. – si dhe nuk është provuar as koha dhe mënyra e transferimit të këtyre shumave nga Greqia në Shqipëri; ii. Duket se subjekti nuk ka deklaruar detyrimin e mbartur prej 3,6 milionë në vitet 2007 dhe 2008, si dhe nuk ka deklaruar në vitin 2009 shpenzimin e kryer për shlyerjen e detyrimit financiar ndaj vëllait të tij – sipas deklarinimit të bërë në “Vetting”; iii. Nuk është provuar as koha dhe as mënyra e transferimit të shumës prej 3,6 milionë lekë nga subjekti i rivlerësimit te vëllai i tij – si shlyerje detyrimi.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me gjetjet e Komisionit për këtë pasuri, si dhe mbi deklarimet relative, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se:

47. Ai u qëndronte deklarimeve periodike të kryera në ILDKPKI dhe pyetësorëve të Komisionit, për sa i përket përdorimit të depozitës prej 4.100.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie.

48. Në lidhje me mosdeklarimin e detyrimit të shumës prej 3,6 milionë lekësh, subjekti është shprehur se e ka deklaruar si depozitë të përbashkët dhe secili nga zotëruesit e depozitës ka pasur të drejta të njëjta në përdorimin e saj. Për këtë arsye nuk është vlerësuar si marrëdhënie huamarrjeje, por si marrëdhënie mirëbesimi midis dy vëllezërve dhe kështu nuk kishte arsye për ta formalizuar me akte noteriale, dhe as të deklarohet si detyrim. Fakti që shuma prej 3,6 milionë lekësh i përkiste z. M. V., ishte deklaruar prej vitit 2006, kur nuk mund të mendonte se do të kishte deklaratë “Vetting”.

49. Për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga z. M. V. – vëllai i subjektit – ky i fundit është shprehur: *“... deklaroj me përgjegjësi të plotë se edhe burimi financiar i kursimeve të vëllait tim – të ardhura nga emigracioni – kanë qenë vetëm nga puna e tij e ndershme si punëtor krahu në një magazinë fruta - perimesh në shtetin grek dhe puna si punëtor kuzhine në të gjitha vendet ku ka qenë emigrant ekonomik...”*

50. Gjithashtu, në seancë dëgjimore – si edhe në pyetësor – subjekti është përgjigjur se vëllai i tij, z. M. V., në periudhën që ka jetuar në Greqi dhe ka kursyer, (së bashku me vëllezërit e tjerë), shumën prej 3,6 milionë lekë, nuk kishte leje qëndrimi dhe rrjedhimisht nuk mund të

²⁵ Për shkak se nuk evidentohet të ketë pasur burime të ligjshme për të akumuluar depozitën prej 4.100.000 lekësh, në vlerën 3.600.000 lekë nga M. V.

punonte i siguruar, kësisoj, nuk janë paguar tatimet dhe as nuk janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore, lidhur me punën e ndershme që ka gjeneruar shumat në fjalë.

Vlerësimi i Komisionit

51. Trupi gjykues çmon se shuma prej 3,6 milionë lekësh, pjesë e depozitës prej 4,1 milionë lekësh, të përdorur për kryerjen e pagesës për blerjen e pasurisë në analizë, nuk mund të konsiderohet me burim të ligjshëm, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për shkaqet e mëposhtme:

51.1 Gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se z. M. V. të kishte siguruar të ardhura nga puna në Greqi, për të cilat të ishin paguar detyrimet tatimore dhe kontributet për sigurimet shoqërore. Përkundrazi, vetë subjekti i rivlerësimit – nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve, por edhe në seancën dëgjimore – e ka përjashtuar këtë mundësi, duke pohuar se nuk mund të provonte pagesën e taksave për këto të ardhura, pasi z. M. V. nuk kishte punuar në Greqi i regjistruar dhe konform legjislacionit civilo-tatimor, për sa kohë ai nuk jetonte atje me një leje qëndrimi. Nuk rezultoi e provuar me dokumente ligjore periudha e qëndrimit në Greqi të z. M. V. dhe as shumat e përfituara nga puna e tij në periudha të caktuara, për të mundësuar një analizë logjike lidhur me mundësitë e tij për të kursyer shumat e depozituara në llogarinë bankare dyemërore.

51.2 Nuk rezultoi i provuar përfitimi dhe posedimi i shumave në fjalë në Greqi, apo depozitimi i tyre në ndonjë institucion bankar atje dhe as transferimi i tyre nga Greqia në Shqipëri. Përkundrazi, nga lëvizjet bankare ka rezultuar që të gjitha shumat janë depozituar *cash* nga bashkëshortja e subjektit, pa specifikuar burimin/prejardhjen e tyre, si rrjedhim nuk vërtetohet që shumat të jenë nga puna në emigracion e vëllait të subjektit.

51.3 Për sa më lart, Komisioni vlerëson se këto të ardhura, prej 3,6 milionë lekësh, nuk mund të konsiderohen të ligjshme, në këndvështrimin e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Lidhur me temën e remitancave nga emigracioni, ky qëndrim i trupit gjykues përkon edhe me vlerësimet orientuese të jurisprudencës, të cilat tashmë janë konfirmuar dhe konsoliduar në sajë të vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (si p.sh: vendimet nr. 3, datë 17.7.2018; nr. 4, datë 25.10.2018; nr. 6 datë 13.9.2018; nr. 9 datë 24.10.2018). Më konkretisht, rezulton se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mënyrë të përsëritur, është shprehur: “... me qëllim që remitancat të vlerësohen në gjykimet pranë Kolegjit, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit ...”.

52. Rrjedhimisht, nga sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm burime financiare të ligjshme për të kryer pagesën për blerjen kësaj pasurie. Gjithashtu, subjekti në deklaratat periodike për vitet 2007 dhe 2008 ka kryer deklarime të pamjaftueshme pasi nuk ka deklaruar në rubrikën përkatëse ekzistencën e detyrimit të mbartur ndaj të tretëve (në rastin konkret shumën prej 3,6 milionë lekësh ndaj vëllait të tij, z. M. V.).

III – Automjet tip “Peugeot”, prodhim i vitit 2011, blerë në vlerën 200.000 lekë

53. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se kjo pasuri është regjistruar në emër të vajzës së subjektit, znj. G. V., në bazë të kontratës nr. ***, datë 26.10.2015.

54. Lidhur me burimin e shumës prej 200.000 lekësh, e cila është përdorur për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se ka rrjedhur nga të ardhurat familjare dhe nga shitja e një automjeti tjetër – më herët, në pronësi të familjes së subjektit.

55. Nga verifikimet e kryera dhe nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për të kryer këtë blerje. Gjithashtu, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e kësaj pasurie.

IV - Lidhur me burimin financiar dhe deklarimet e subjektit mbi gjendjen *cash* në banesë dhe mbi shumat monetare të ruajtura në depozitat bankare

56. Nga hetimi administrativ është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në banesë, në monedhën lekë, duke nisur prej deklarimit të vitit 2006 e në vijim, por përmbajtja e këtyre deklarimeve shpesh nuk ka qenë tërësisht e qartë²⁶ dhe në përputhje me kërkesat e formularit, pasi nuk janë përshkruar saktësisht shumat e deklaruara, me cilësimin si shtesa dhe si pakësime.

57. Tabela që pasqyron deklarimet e subjektit lidhur me gjendjet *cash*, si më poshtë vijon:

	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Vlera	1 500 000	800 000	900 000	1 000 000	400 000	1 000 000	2 000 000	600 000	1 560 000	300 000	1 400 000
Përshkrimi		Gjendje CASH, kursime vitit 2007	Kursime gjatë vitit 2008	Gjendje lekë në banesë nga kursimet vjetore	Gjendje lekë në banesë nga kursimet vjetore	Gjendje lekë në banesë nga kursimet vjetore	Gjendje lekë ardhurave të përfituara gjatë vitit 2012	Gjendje lekë CASH të krijuara nga diferenca e të ardhurave të përfituara gjatë vitit 2013	Gjendje lekë CASH të krijuara nga diferenca e të ardhurave të përfituara gjatë vitit 2014	Gjendje lekë CASH të krijuara nga diferenca e të ardhurave të përfituara gjatë vitit 2015	Gjendje lekë CASH të krijuara nga diferenca e të ardhurave të përfituara gjatë vitit 2016

58. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të njëjtën gjendje *cash* si në fund të vitit 2016 (1.400.000 lekë), me burim krijimi nga të ardhurat nga paga dhe aktiviteti i bashkëshortes.

59. Gjithashtu është konstatuar ekzistenca e një depozite në “Credins Bank”, në vlerën 4.085.784,33 lekë – e deklaruar në deklaratën “Vetting” në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. F. V., me burim krijimi të ardhura nga paga dhe, në vijim, të ardhura nga aktiviteti privat si notere.

60. Kjo depozitë fillon të krijohet në datën 9.10.2012, me derdhjen *cash* të shumës 1.500.000 lekë, burimi i deklaruar i krijimit të së cilës në vitin 2012 ka qenë kursime të viteve 2010 dhe 2011, ndërkohë që, i njëjti burim është deklaruar edhe për gjendjen *cash* për këtë vit.

61. Nga analiza financiare e kryer nga njësia ligjore për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit rezulton me një bilanc negativ prej 600.684 lekësh, çka do të thotë se familja e subjektit, me të

²⁶ Lidhur me këtë paqartësi është pyetur subjekti, i cili ka dhënë shpjegimet e tij, duke konfirmuar përmbajtjen e deklarimeve në fjalë, duke shpjeguar se ai, kur nuk e ka specifikuar shifrën e deklaruar si kursim të atij viti (shtesë), deklarimi i është referuar gjendjes totale të disponibiliteteve financiare në banesë në atë moment.

ardhurat e ligjshme, nuk mund të mbulonte të gjitha kursimet e deklaruara – si gjendje në bankë dhe si *cash* në banesë.

62. Më 14.5.2013, bashkëshortja e subjektit ka derdhur *cash* në llogarinë bankare shumë prej 914.000 lekësh dhe, së bashku me interesin e akumuluar, shumë prej 1.000.000 lekësh e kalon në depozitë bankare, duke e shtuar në depozitën ekzistuese. Burimi i deklaruar i kësaj shtese janë kursimet *cash* dhe interesat e akumuluar.

63. Gjithashtu, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit, në datën 11.4.2014, ka derdhur *cash* në llogarinë bankare, shumë prej 886.700 lekësh dhe, së bashku me interesin e akumuluar, shumë prej 3.000.198 lekësh e kalon në depozitë bankare. Burimi i deklaruar i kësaj shtese janë kursimet *cash* të vitit 2013 dhe interesat e akumuluar. Njëkohësisht, subjekti deklaron edhe një shtim të gjendjes *cash* prej 1,5 milionë lekësh, për vitin 2014.

64. Nga analiza financiare për vitin 2014, subjekti rezulton me një bilanc negativ prej 428.975 lekësh, për rrjedhojë, ka pasur një mungesë të burimit financiar të ligjshëm për këtë vlerë, për të justifikuar shtimin e kursimeve të deklaruara – si në gjendjen në llogarinë bankare, ashtu edhe *cash* në banesë.

65. Duke konsideruar uljen e gjendjes *cash* në vitin 2015, mund të thuhet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të përballuar shtimin e konstatuar në depozitën bankare, edhe pse, nga analiza financiare për vitin 2015, rezulton me një bilanc negativ, i papërfillshëm në vlerësimin tërësor, prej 86.416 lekësh.

66. Përgjatë vitit 2016, në depozitën në fjalë nuk rezulton të janë kryer derdhje, por është shtuar vetëm akumulimi i interesave, por nga ana tjetër, për këtë vit subjekti ka deklaruar një shtim të gjendjes *cash* në shumë prej 1,4 milionë lekësh, ndërkohë që, sipas analizës financiare të këtij viti subjekti rezulton me një bilanc negativ prej 152.127 lekësh.

67. Nga një vlerësim tërësor i situatave të sipërpërkruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme që të krijonte të gjitha kursimet e deklaruara *cash* në banesë dhe, njëkohësisht, të depozitonte të gjitha shumat që kanë rezultuar të kenë qarkulluar dhe depozituar në llogaritë bankare në fjalë, pasi rezulton e pajustificuar një shumë prej 1.181.786 lekësh.

V - Analiza Financiare

68. Në mënyrë të detajuar, sipas viteve, në vijim u paraqitën të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe mjaftueshmërinë e likuiditeteve për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet me të ardhura të ligjshme. Në këtë analizë në vitin 2006 – vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë në ILDKPKI – është marrë në konsideratë, nisur nga disponibiliteti real, shuma prej 3.6 milionë lekësh (si pjesë përbërëse e depozitës prej 4.1 milionë), për të evituar një efekt të dyfishtë, pasi ajo nuk është konsideruar me burim të ligjshëm të provuar dhe, për rrjedhojë, nuk është përfshirë në burimet për blerjen e vitit 2007.

69. Në tabelën në vijim pasqyrohen rezultatet e analizës financiare të kryer nga njësitë ligjore e Komisionit, duke përlllogaritur të dhënat vjetore, të përmbledhura për periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2016, lidhur me: pasuritë *neto*, (pasuri apo asetë të blera – detyrimet); të ardhurat e dokumentuara; shpenzimet dhe, në fund, rezultati, i cili tregon mundësinë e subjektit për të

përballuar investimet dhe shpenzimet, si për të kursyer shumat e deklaruara me të ardhurat e ligjshme²⁷.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	2 729 575	808 299	100 000	-600 000	600 000	2 500 000	-899 907	1 960 105	1 902 997	2 910 961
Shtëpi banimi me Sip. 78 m2, nga Enti I Banesave											270 540
Prenotim apartament Sip. 92 m2, 41 000 EUR Tiranë		3 929 575	708 299								
Arredim shtëpie										440 000	
Blerje automjet VW touareg ***										1 522 361	
Blerje automjet Peugeot ***										200 000	
Ri-konstruksion apartamenti											1 405 471
Ndryshim likuiditeti	0	-1 200 000	100 000	100 000	-600 000	600 000	2 500 000	-899 907	1 960 105	-259 364	1 234 950
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	2 000 000	800 000	900 000	1 000 000	400 000	1 000 000	3 500 000	2 600 093	4 560 198	4 300 834	5 535 784
DETYRIME	0	0	0	-643 800	-1 506 293	-1 449 907	0	0	0	0	0
Kredi konsumatore 3 000 000 leke prane RZB				2 956 200	-1 506 293	-1 449 907					
Detyrim ndaj vella M. V.				-3 600 000							
PASURI NETO	0	2 729 575	808 299	743 800	906 293	2 049 907	2 500 000	-899 907	1 960 105	1 902 997	2 910 961
TE ARDHURA deklaruar	1 428 500	1 782 000	1 974 455	2 497 164	2 764 351	3 168 041	2 894 077	2 176 653	3 333 420	3 179 410	4 518 320
TE ARDHURA dokumentuar	1 280 348	1 575 125	1 879 347	2 728 815	2 845 511	2 799 787	2 475 987	1 332 090	3 333 420	3 169 982	4 518 320
Paga SR	635 500	798 000	938 898	1 261 533	1 462 125	1 916 595	1 734 422	1 152 659	1 190 524	1 183 015	1 415 442
Paga BSH	793 000	984 000	1 035 557	1 235 631	1 302 226	1 123 246	1 159 655	985 000	2 029 491	1 909 759	2 341 578
Të ardhura nga interesat bankare								38 994	113 405	86 636	84 950
Të ardhura nga shitje mjeti VW touareg ***											676 350
Të ardhura nga vendime gjyqesore											
Kthime të primeve të sigurimit						128 200					
Paga SR vertetur	372 550	580 420	769 238	1 357 383	1 541 991	1 546 303	1 403 333	1 190 524	1 190 524	1 173 587	1 415 442
Paga BSH vertetur	907 798	994 705	1 110 109	1 371 432	1 303 520	1 125 284	1 072 654	102 572	2 029 491	1 909 759	2 341 578
SHPENZIME	747 486	986 191	938 240	976 813	843 428	628 038	576 671	1 178 376	1 802 290	1 400 890	1 759 486
Shpenzime për pagesë vullnetare të sigurimeve			226 080								
Shpenzime jetese	438 228	943 872	546 480	546 480	546 480	546 480	564 096	564 096	879 992	900 000	940 368
Intersa + shpenzime per kredine				416 616	290 007	81 558					
Shpenzime shkolle për fëmijët									360 308	316 211	311 279
Aplikim per vize										78 000	
Sigurime në udhëtim dhe sigurime të tjera									560	5 506	
Humbje nga shitja mjetit VW touareg ***											
Shpenzime udhëtimi	309 258	42 319	165 680	13 717	6 941		12 575	614 280	561 429	101 173	507 839
Analiza deklaruar	681 015	-1 933 766	227 915	776 551	1 014 630	490 096	-182 594	1 898 184	-428 975	-124 477	-152 127
Analiza dokumentuar	532 863	-2 140 641	132 807	1 008 202	1 095 790	121 842	-600 684	1 053 621	-428 975	-133 905	-152 127
Kursi i këmbimit	123,703	120,91	123,1825	137,17	138,81	138,3	139,72	140,21	140,11	137,65	135,27
likuiditete deklaruar	93,672	83,03	90,96	93,98	104,95	105,08	106,57	102,38	113,64	126,64	128,29
CASH në lekë	1 500 000	800 000	900 000	1 000 000	400 000	1 000 000	2 000 000	600 000	1 560 000	300 000	1 400 000
Diferenca e pa mbuluar	(3 456 331)										

70. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmon se në një vlerësim të përgjithshëm të kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Vata, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme – sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara, pasi për periudhën 2006 – 2016 ka një diferencë të pajustificuar me të ardhura të ligjshme, në shumën totale

²⁷ Diferenca me minus në vitin 2006 nuk është përfshirë në minusin total, pasi vjen si rezultat i ndryshimit të likuiditetit për fillimin e analizës, por në vetvete, balanca e këtij viti rezulton pozitive.

prej 3.456.331 lekësh dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se duhet të aplikohet pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

71. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata. Për këtë qëllim, ajo ka përcjellë një raport me nr. *** prot., datë 20.7.2018, për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar pjesërisht – në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit*”.

72. Sipas këtij raporti: “[...] disponohen të dhëna, në bazë të të cilave për subjektin Hysni Vata, ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive, gjatë procesit të hetimeve në disa çështje penale pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër si dhe në Drejtorinë e Policisë të qarkut Dibër, [...] për një periudhë relativisht të gjatë kohe dhe në më shumë se një rast, rrethana këto që e bëjnë subjektin e rivlerësimit person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale, si dhe një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale [...]”.

73. Gjithashtu, në raportin e DSIK-së, të sipërcituar, shtohet se: “[...] Informacionet që disponohen në ngarkim të z. Hysni Vata, për implikimin e tij në veprimtari korruptive, evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm, sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në formën e një takimi të qëllimshëm në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit [...]”.

74. Nisur nga sa më lart **Grupi i Punës së DSIK-së, duke rishikuar konstatimin fillestar, të dërguar me nr. *** prot., datë 20.7.2018, arrin si përfundimin mbi papërshtatshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës nga z. Hysni Vata.**

75. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, kreu verifikime nëpërmjet administrimit, studimit dhe analizimit të disa dosjeve profesionale, si dhe të dokumentacionit të klasifikuar që lidhej me këtë subjekt rivlerësimi.

76. Komisioni i njoftoi subjektin të rivlerësimit, me anë të rezultateve të hetimit kryesisht, konstatimet dhe konkluzionet e arritura nga Grupi i Punës së DSIK-së, në lidhje me papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës, i cili shpjegoi në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore se konkluzionet e DSIK-së nuk qëndronin, pasi ai nuk ishte përfshirë ndonjëherë në veprimtari korruptive dhe nuk kishte pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm.

77. Nga hetimi administrativ dhe rivlerësimi i kryer nga Komisioni, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, bazuar në provat dhe dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se, në raportin e dërguar nga DSIK-ja vlerësimi i kryer nuk përmban rrethana bindëse, të tilla që merren parasysh në konstatimin përfundimtar të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme, me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi rrethana të tjera, mbi veprime korruptive të përsëritura, nuk rezultojnë të provuara/bazuara mjaftueshëm, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to.

78. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, të dhënat dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit – sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 – por ato do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të rivlerësimit të tij.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

79. Komisioni ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në:

- i. raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP);
- ii. informacione të tjera të marra gjatë hetimit administrativ nga organet ligjzbatuese;
- iii. kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacion, lidhur me statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;
- iv. denoncimet nga publiku.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT TË AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLP-ja

80. Komisioni ka administruar raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë – bazuar në rregulloren “Për Vlerësimin Etik e Profesional të Subjekteve në Proces Rivlerësimi” - të miratuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike – për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit Hysni Vata, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) *aftësitë profesionale;*
- b) *aftësitë organizative;*
- c) *etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;*
- ç) *aftësitë personale dhe angazhimi profesional.*

81. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizën e:

- i. formularit të vetëdeklarimit si dhe të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii. *pesë* dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii. të dhënat nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, struktura të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të administruara nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë në Republikën e Shqipërisë.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

82. Nga verifikimi i të dhënave nga 21 prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Republikën e Shqipërisë, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Vata:

82.1 Të ketë pasur masa disiplinore;

82.2 Të ketë të dhëna apo informacione të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;

82.3 Të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht, apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale);

82.4 Të ketë pasur ndaj tij materiale hetimore të regjistruara, procedime penale të pushuara apo pezulluara.

83. Sektori i protokoll – arkivës në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2018, bën me dije se, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2018, rezultojnë këto praktika të ankesave:

83.1 Praktika nr. *** prot., viti 2011, për ankesën e shtetasit B. K.

83.2 Praktika nr. *** prot., viti 2018, për ankesën e shtetasit F. S..

84. Nga praktikat bashkëlidhur, konstatohet se janë trajtuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme dhe i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. *** prot., datë 17.4.2018.

85. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 29.5.2018, regjistruar me nr. *** prot., datë 1.6.2018, ka dërguar bashkëlidhur aktet e kallëzimit penal nr. ***, datë 15.12.2017, që kanë të bëjnë me subjektin e rivlerësimit.

86. Nga aktet e dosjes, rezulton se mbi bazën e kallëzimit penal nr. ***, datë 30.11.2017, të ardhur për trajtim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë ka regjistruar kallëzimin penal me nr. ***, datë 15.12.2017. Shtetasi I. T., në datën 30.11.2017, ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin kallëzim penal, me pretendimin për manipulim të procesit penal nga Prokuroria e Rrethit Dibër, nga mjekësia ligjore, si dhe të përkrahur nga gjykata, lidhur me një ngjarje të datës 23.9.2015, ku ka ngelur i vrarë djali i tij, i ndjeri N. T. Rezulton se në përfundim të verifikimit të kallëzimit, prokurori, bazuar në nenin 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me argumentin se nuk konstatohen elementë të veprës penale; kallëzuesi nuk është paraqitur para organit procedues me gjithë njoftimet e marra dhe nuk ekzistojnë shkaqe ligjore për fillimin e ndjekjes penale. Vendimi i është komunikuar për dijeni shtetasit I. T. me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2018.

87. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën N nr. *** prot., datë 8.1.2019, ka bërë të ditur se në regjistrin e njoftimit të veprave penale në këtë zyre, nuk rezulton që për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Vata, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Në shkresë informohet se ndaj tij është regjistruar kallëzimi penal me numër 29 i vitit 2016, për të cilin është vendosur mosfillim procedimi. Bashkëlidhur shkresës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka dërguar fashikullin

e mosfillimit të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2016. Kallëzimi penal nr. *** rezulton i regjistruar në datën 12.2.2016, mbi bazën e materialit kallëzues të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Task - Forcë, me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 5.2.2016, nëpërmjet së cilës është dërguar për kompetencë ankimi në dorëshkrim i shtetasit H. P., banues në Dibër, i cili ka paraqitur ankimin në Ministrinë e Drejtësisë. Kjo e fundit ka përcjellë për kompetencë ankimin në Prokurorinë e Përgjithshme. Në ankesë janë parashtruar shqetësime për veprime korruptive të kryeplakut të fshatit ***, të disa punonjësve të Policisë së Shtetit dhe prokurorit, subjekt rivlerësimi.

88. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka konstatuar se pretendimet janë të lidhura me veprimet e policisë dhe prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, gjatë hetimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2015, të filluar në bazë të referimit të ankuesit. Në analizë të fakteve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vlerësuar se nuk rezulton asnjë e dhënë që prokurori i çështjes Hysni Vata të ketë konsumuar elementë të veprës penale “*Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe as ndonjë vepër penale tjetër. Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndërmjet të tjerash, prokuroria ka argumentuar se në pretendimet e parashtruara nga ankuesi nuk evidentohet asnjë gjetje, fakt apo provë që mund të përbëjë dyshim të arsyeshëm mbi ekzistencën e elementëve të veprës penale, të parashikuar nga neni 319 dhe 319/ç, apo ndonjë veprë tjetër penale, që vendimi i datës 15.12.2015, i prokurorit të çështjes për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2015, të jetë marrë si rezultat i përfitimeve të parregullta të përfituara prej tij. Në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin “*Për mosfillimin e procedimit penal*”, datë 10.10.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal duke u shprehur në pjesën konkluduese se del qartë që fakti nuk rezulton.

89. Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2019, informon se nga të dhënat që ndodhen në dosjen personale, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Hysni Vata, nuk rezulton të ketë masa disiplinore. Gjithashtu, informohet se me dekretin nr. ***, datë 19.2.1999, të Presidentit të Republikës, prokurori është larguar nga detyra për zvarritje të rënda në kryerjen e detyrës pas propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe, me dekretin nr. ***, datë 29.7.2008, të Presidentit të Republikës është rikthyer në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Tropojë. Bashkëlidhur gjenden dokumentet shoqëruese, konkretisht: shkresa nr. *** prot., datë 26.12.1999, e Prokurorisë së Përgjithshme, shkresa nr. *** prot., datë 15.2.1999, e Drejtorisë së Personelit në Prokurorinë e Përgjithshme, vendim nr. *** prot., datë 22.10.2001, e Gjykatës së Lartë, shkresa nr. *** prot., datë 31.7.2008, e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, dekret “*Për transferim prokurori*”, me nr. ***, datë 29.7.2008, i Presidentit të Republikës.

90. Pranë këtij sektori ka të dhëna për punësimin, periudhat përkatëse, prokurorinë ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën dhe të dhëna për vlerësimin e punës së prokurorit, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të germës “d”, të pikës 2, të nenit 160, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e Gjyqtarit dhe Prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, ku konkretisht janë administruar:

- 90.1 Vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2014, për prokurorin Hysni Vata, në nivel “shumë mirë”;
- 90.2 Vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2015, për prokurorin Hysni Vata, në nivel “shumë mirë”;
- 90.3 Vlerësimi i punës për drejtuesin e Prokurorisë, Hysni Vata, për vitin 2016, akt i Prokurorit të Përgjithshëm.

ANALIZA E GJETJEVE NGA KLP-ja

91. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, tre akte të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën e I-rë të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2, dokumenti 3”. Ndërsa pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

92. Lidhur me disa dosje është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka mangësi në përshkrimin e saktë të bazës ligjore. Por gjithsesi, sipas KLP-së, mospërputhja e bazave ligjore në këto akte, nuk ka prekur unitetin e pjesëve përbërëse të tyre dhe nuk ka ndikuar në zgjidhjen e çështjeve nga gjykata.

93. Në përfundim të analizës së mësipërme, KLP-ja – duke marrë parasysh edhe vlerësimin e subjektit “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 – ka konkluduar se nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale ose të etikës, apo paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata.

C/2 RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

94. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – duke pasur parasysh faktin që janë paraqitur një numër i konsiderueshëm denoncimesh – ka kryer një rivlerësim tërësor të kriterit profesional, nëpërmjet një kombinimi të balancuar midis raportit të sipërpërmendur dhe vlerësimit të dosjeve dhe problematikave profesionale të denoncuar, ose të administruara në sajë të informacioneve të rezervuara dhe/ose të klasifikuara, si më lart.

95. Duke konsideruar faktin se lidhur me konkluzionet e raportit të KLP-së që u përshkrua më sipër, trupi gjykues vijon me analizimin e këtij komponenti, duke mbajtur në konsideratë edhe përmbajtjen e informacioneve të tjera, të administruara nga Komisioni ose të njohura nga anëtarët e trupit gjykues – për të mbërritur kështu në konkluzionet mbi kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

Denoncimet e publikut për subjektin e rivlerësimit

96. Rezulton se pranë Komisionit – bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016 – për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Vata, janë paraqitur nga publiku, nëntë denoncime, të cilët janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Çështjet në të cilat, pas analizimit të tyre – në sajë të

ankesave të paraqitura në disa nga denoncimet në fjalë – janë evidentuar problematika apo mangësi, do të trajtohen më poshtë.

97. Në vijim të denoncimeve nga publiku dhe të informacioneve të tjera të marra nga Komisioni, nëpërmjet organeve ligjzbatuese, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa dosje hetimore dhe gjyqësore. Për një vlerësim më të plotë të kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit, janë studiuar aktet, vendimet ose materialet e dosjeve në fjalë, dhe nga analiza e të cilave ka rezultuar sa vijon.

1. Lidhur me denoncimin datës 10.4.2019, të znj. N. C.

98. Në këtë denoncim, shtetasja në fjalë është shprehur se subjekti, Hysni Vata, ka pushuar një hetim mbi falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuar për të përfituar një trashëgimi të bashkëshortit të saj, nëpërmjet përdorimit të një vendimi gjyqësor që nuk ishte kryer fare (pasi vendimi ishte marrë të nesërmen e paraqitjes së kërkesës në sekretarinë gjyqësore), dhe gjithsesi, nga ekspertiza e kërkuar dhe urdhëruar pikërisht nga prokurori Hysni Vata, ka rezultuar se kërkesat e paraqitura në gjykatë nuk kanë qenë të firmosura nga personat të cilëve ato i referoheshin. Pra, falsifikimi i firmave ishte konstatuar përgjatë hetimit në fjalë, por kjo nuk ka mjaftuar për të çuar dosjen për gjykim.

99. Komisioni – pasi ka analizuar materialin e administruar ose të paraqitur nga denoncuesja – vlerëson se hetimi në fjalë nuk rezulton të jetë mjaftueshëm i thelluar dhe gjithëpërfshirës për të hedhur dritë mbi parregullsitë e administrimit dhe të modifikimit të të dhënave personale në Zyrën e Gjendjes Civile Burrel, edhe pse ndërkohë ka pasur një parashkrim të veprës së falsifikimit të kërkesave të paraqitura në gjykatë në vitin 1991. Gjithashtu, rezultoi se në këtë procedim nuk janë kryer mjaftueshëm hetime apo vlerësime analizuuese, nën këndvështrimin e ekzistencës së mundshme të konsumimit të veprës penale të mashtrimit apo të ndonjë vepre penale tjetër – duke u mjaftuar me një vlerësim sipërfaqësor.

100. Përveç të tjerash, nga kjo dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka konkluduar as për ekzistencën e elementeve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve – edhe pse ekspertiza, së paku, në dy raste ka konstatuar se firmat e kërkesave të paraqitura në gjykatë realisht ishin falsifikuar. Gjithashtu, nga dokumentacioni i analizuar rezulton se në rastin në fjalë, prokuroria nuk është shprehur as për parashkrim të mundshëm dhe as mbi veprën e mundshme të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara.

101. Për sa u përshkrua më lart, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në rastin konkret, nuk ka kryer hetimeve të plota dhe gjithëpërfshirëse dhe ka mbërritur në konkluzione hetimore të cunguara, të cilat nuk përputhen me faktet e konstatuara.

*2. Lidhur me procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit I. K.*

102. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se në datën 27.11.2011, subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Vata, në cilësinë e prokurorit (dhe drejtuesit) pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, urdhëroi kryerjen e regjistrimit të procedimit penal nr. ***, ndaj shtetasit I. K. dhe ngarkon një tjetër prokuror, R. T., dhe një OPGJ për kryerjen e hetimeve.

103. Në datën 27.11.2011 – edhe pse çështja ishte e deleguar te një tjetër prokuror – vetë subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kërkesë për vlerësimin e arrestit të personit të akuzuar.

Gjithashtu, në datën 28.11.2011, z. Hysni Vata ka përfaqësuar Prokurorinë në seancën gjyqësore – të zhvilluar pranë gjykatës kompetente – ku ka kërkuar aplikimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”.

104. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, në datën 28.11.2011, e ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në fjalë dhe ka vendosur një masë sigurimi personal “arrest në burg”, me afat 30 ditë.

105. Në datën 6.12.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, duke pranuar kërkesën e të akuzuarit, e revokon vendimin nr. ***, për masë sigurie “arrest në burg” me afat 30 ditë dhe urdhëron lirim të tij. Ndërkohë që, prokuroria kishte kërkuar zëvendësimin e masës me detyrim paraqitjeje pranë policisë gjyqësore.

106. Në datën 20.12.2011, prokuroria, pasi ishin kryer: veprimet hetimore, ekspertiza (nga e cila nuk ishin konstatuar shkelje të rregullave të qarkullimit nga i akuzuari) dhe dëgjimi i dëshmitarëve, ka vendosur pushimin e çështjes nr. ***, të regjistruar ndaj shtetasit I. K., me arsyetimin se ai nuk ka kryer vepër penale.

107. Nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni ka konstatuar një mospërputhje substanciale midis deklarimeve të personit nën hetim, I. K., dhe deklarimeve të një dëshmitari (Xh. K.). Gjithashtu, rezulton një mospërputhje midis qëndrimit përfundimtar/konkluzioneve të Prokurorisë dhe fakteve që rezultojnë nga dokumentacioni dhe nga aktet e administruara në dosjen në fjalë. Konkretisht, në datën 26.11.2011, sipas procesverbalit të marrjes së të dyshuarit në pyetje, rezulton se:

107.1 Shtetasi I. K. ka pohuar: “[...] gjatë udhëtimit me mua në makinë ka qenë kushëriri im, që quhet E. Sh. K. [...]”. Ndërsa, si nga procesverbali i policisë, por edhe nga akti i ekspertizës, dhe po ashtu edhe nga deklaratimet e vetë dëshmitarit (XH. K.), rezulton se pasagjeri në mjetin (kamionin), në momentin e aksidentit, që drejtohej nga i dyshuari, kishte qenë shtetasi Xh. Sh. K. dhe jo shtetasi E. Sh. K.

107.2 Gjithashtu, rezultoi se personi nën hetim I. K., ka deklaruar përpara OPGJ-së, në datën 26.11.2011, se po në atë datë, gjatë udhëtimit – të nisur nga Fushë-Kruja, rreth orës 11:30, dhe deri sa kanë mbërritur në Bulqizë (vendi i aksidentit), rreth orës 16:00 – “nuk kemi ndaluar në asnjë vend...”. Por, nga ana tjetër dëshmitari dhe bashkëudhëtari me të akuzuarin, i pyetur në datën e aksidentit, 26.11.2011, ka deklaruar se: “[...] ata, përgjatë udhëtimit në fjalë, kishin ndaluar në Milot dhe kishin konsumuar ushqim [...]”.

108. Nga sa më lart rezulton se hetimet në fjalë nuk kanë qenë të plota dhe nuk janë përshkruar të gjitha faktet e evidentuara gjatë hetimit, pasi nuk konstatohet që në aktet e Prokurorisë të janë pasqyruar mospërputhjet e sipërcituara. Po ashtu, nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor për verifikime të mëtejshme, me qëllim qartësimin dhe përcaktimin e versionit real (si p.sh. verifikimi nëse ekzistonte ndonjë person me emrin E. Sh. K.; nëse po, marrja në pyetje e shtetasit në fjalë; ridëgjimi i deklaruesve të mësipërm, me qëllim kundërshtimin e deklarimeve të dyshimta; ballafaqimin e tyre nëse do të ishte nevoja).

109. Për rrjedhojë, duket se në këtë procedim ka pasur mangësi në hetime, duke mos hedhur plotësisht dritë mbi dinamikën dhe rrjedhën e ngjarjeve, ditën që kishte ndodhur aksidenti rrugor (objekti i mundshëm i veprës penale të dyshuar). Gjithashtu, një tjetër mangësi hetimore konsiston në mosngritjen e dyshimeve nga prokuroria dhe në mosverifikimin e mëtejshëm të

fakteve, lidhur edhe me konsumimin e mundshëm nga ana e dëshmitarit (Xh. K.), të veprës penale të deklarimit të rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore, e parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal. Vendimi i pushimit të dhënë nga prokuroria, minimalisht duhet të prezumojë/vlerësojë vërtetësinë e versionit të fakteve që ka pohuar i dyshuari (I. K.) dhe, për rrjedhojë, shtetasi Xh. K. duhet të ketë deklaruar fakte të rreme përgjatë dëgjësës së tij nga OPGJ-ja.

110. Për sa më lart, lidhet direkt me mangësi të kryera në aktivitetin profesional të kryer nga subjekti – jo vetëm si drejtues, por edhe si urdhërues dhe përmbushës i disa veprimeve hetimore në këtë dosje – ndonëse për këtë detyrë, zyrtarisht dhe formalisht, ishte deleguar prokurori R. T. Kjo qasje *proactive* e z. Hysni Vata, në kryerjen e disa veprimeve hetimore personalisht, nga njëra anë rezulton në kapërcim të kompetencave të drejtuesit – sipas të cilave ai vetëm duhej të verifikonte aktin përfundimtar të hetimeve duke e miratuar apo shfuqizuar atë. Ndërsa, nga ana tjetër konfirmon (edhe pse në mënyrë të tërthortë) dyshimet e ngritura nga informacione të klasifikuara, lidhur me veprimtarinë e subjektit në këtë procedim.

111. Nga sa më lart, Komisioni çmon se z. Hysni Vata, në këtë dosje – të përfunduar me një vendim pushimi të dyshimtë dhe me hetime të paplota – ka munguar të evidentojë mangësitë hetimore, në cilësinë e drejtuesit dhe ka miratuar një vendim pushimi të pabazuar në fakte. Rezulton gjithashtu se subjekti ka pasur një përfshirje të tejskajshme në këtë procedim – në kapërcim të kompetencave të tij. Këto veprime bien ndesh me detyrimin e shtuar të magjistratit në respektimin e kompetencave institucionale, si dhe me parimin e paanshmërisë, rrethana këto që cenojnë besimin e publikut te figura e prokurorit.

*3. Lidhur me procedimin penal nr. ****

Komisioni, pas studimit të dosjeve hetimore dhe gjyqësore që i përkisnin këtij procedimi ka konstatuar sa vijon:

112. Në datën 28.8.2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit E. D., për veprën penale “plagosje e rëndë me dashje”, neni 88/1 i Kodit Penal.

113. Në datën 30.8.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, duke pranuar kërkesën e Prokurorisë, me vendimin nr. *** ka caktuar masë sigurie personale “arrest në burg” për të dyshuarin E. L.; vendimi në fjalë është miratuar edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, më 19.9.2014.

114. Në datën 8.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. ***, ka pranuar kërkesën e të dyshuarit dhe ka zëvendësuar masën e sigurisë, nga arrest në burg në detyrim paraqitjeje pranë policisë gjyqësore. Ky vendim është ankimuar nga prokuroria në fjalë, por Gjykata e Apelit Tiranë e ka lënë atë në fuqi.

115. Në datën 20.11.2014, duke konsideruar rëndësinë e fakteve dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale nga shtetasi E. L. – i cili e kishte pranuar konsumimin e saj – subjekti ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurisë ndaj të dyshuarit, nga detyrim paraqitjeje në arrest në burg, si dhe në datën 15.12.2014, urdhëron kryerjen e disa veprimeve hetimore shtesë.

116. Në datën 23.11.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. ***, ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka zëvendësuar masën e sigurisë, nga detyrim paraqitjeje pranë policisë gjyqësore për të dyshuarin, në arrest në burg të tij.

117. Në datën 26.2.2015, subjekti i rivlerësimit – pasi kishte mbyllur hetimet dhe më 27.12.2014 kishte kërkuar gjykimin e çështjes nga gjykata kompetente – në konkluzionet e tij përfundimtare – duke pasur parasysh faktin që i dyshuari E. L. e ka pranuar kryerjen e veprës penale dhe është penduar, si dhe rrethanën e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit²⁸ – ka kërkuar dënimin e E. L. me 3 vjet burg, dhe në sajë të gjyimit të shkurtuar që ka kërkuar i pandehuri, subjekti kërkon një dënim përfundimtar prej dy vitesh burg. Pra, është kërkuar dënimi minimal, pasi neni 88/1 i Kodit Penal parashikon një dënim nga 3 deri në 10 vjet për këtë veprë penale.

118. Në datën 19.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. ***, ka dënuar shtetasin E. L. me 3 vjet e 6 muaj burg, duke ia ulur dënimin me 1/3, në 2 vjet e 4 muaj, në sajë të aplikimit të nenit 406 Kodit të Procedurës Penale, pasi është gjykuar me gjykim të shkurtuar.

119. Vendimi i mësipërm ishte ankimuar nga i dënuari, dhe në datën 23.10.2015, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, e ka lënë në fuqi dënimin në fjalë, duke shtuar një pikë në dispozitiv, me të cilën ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 88, në pjesën e pavuajtur, dhe ka caktuar një afat prove prej 18 muajsh për shtetasin E.L.

120. Komisioni vlerëson se, lidhur me sa më lart, nuk janë konstatuar problematika procedurale apo mangësi në veprimet hetimore nga subjekti i rivlerësimit, por rezulton se ky i fundit ka kërkuar një dënim përfundimtar, minimal, prej dy vitesh burg – pa bërë ndonjë argumentim logjiko-faktik lidhur me këtë zgjedhje. Ndërkohë që, nga dokumentacioni i administruar nuk kanë spikatur shkaqe apo rrethana lehtësuese që mund të justifikonin një kërkesë për një masë të tillë dënimi – pro të dyshuarit – në një kohë që nga parashikimi ligjor, dënimi i mundshëm niste nga 3 vjet dhe mund të shkonte deri në 10 vjet burg.

GJETJE NGA ONM

121. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, me shkresën nr. *** prot., datë 25.6.2019, pasi ka administruar dhe studiuar disa dosje hetimore të administruara/hetuara nga subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Vata, në bazë të nenit B të Aneksit t Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit një gjetje, që konsiston në analizën dhe shqyrtimin e aftësive profesionale të subjektit, lidhur me disa procedime penale të hetuara prej tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

122. Trupi gjykues, pasi i analizoi gjetjet e paraqitura nga ONM-ja, së bashku me dosjet profesionale mbi të cilat ato bazohen, çmoi që t'i bëjë pjesë të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, përmbajtja e të cilave është përmbledhur në vijim:

Analizë e dosjeve për veprën “shkelje e rregullave të sigurisë teknike në punë”

Çështja nr. 1

²⁸ Të paraqitura nëpërmjet një deklarate noteriale të datës 22.12.2014, me të cilën i dëmtuari (Gj. L.) shpreh mospasjen e konflikteve të mëtejshme me të pandehurin.

123. Më 17.12.2011, policia e Bulqizës u njoftua se shtetasi B. P. u plagos dhe ndërroi jetë në punë, në minierën e kromit të administruar nga kompania “****” sh.p.k., në Bulqizë.

124. Më 3.1.2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2012, për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Më 20.11.2012, subjekti i rivlerësimit vendosi të mbyllë procedimin penal.

125. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të këtij procedimi penal, ka arritur në konkluzionin se **vdekja e punonjësit erdhi prej fajit të viktimës, sepse ai dhe kolegët e tij, sipas urdhrin të administratorëve të kompanisë, nuk duhet të kishin punuar të shtunave dhe të dielave, por ata dolën në punë me iniciativën e tyre.**

126. Dokumentet dhe provat e administruara **nuk mjaftojnë për të arritur në një përfundim të tillë**, për arsyet e mëposhtme:

126.1 Përfundimi u bazua kryesisht në dëshmitë e punonjësve. Ata që punonin me viktimën në të njëjtën ditë thanë se ishin “nevojtarë” dhe shkuan të punonin të shtunën, sepse kishin nevojë për para. Duket se ata kishin një pritshmëri se do të paguheshin nëse punonin të shtunën. Zyrtarët e kompanisë thanë se punëtorët ishin atje me iniciativën e tyre pasi ata (zyrtarët) kishin urdhëruar që askush të mos punonte të shtunave dhe të dielave, por nuk kishin asnjë dëshmi për ta mbështetur/provuar këtë deklaratë. Rojet e galerisë ku ndodhi aksidenti pretendonin se viktima ishte marrë në telefon nga administratori dhe i ishte thënë se askush nuk duhet të punonte të shtunën dhe të dielën dhe se ai i tha ekipit të punëtorëve, përfshirë viktimën, se nuk u lejohej të punohej atë ditë, por megjithatë, ata këmbëngulën që të punonin, dhe me vullnetin e tyre nënshkruan një procesverbal për këtë.

126.2 Skenari i mësipërm është në qendër të vendimit të prokurorit për të mbyllur procedimin duke fajësuar viktimën, edhe pse ai nuk ka bërë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e asaj deklaratë pasi ai: (a) nuk ka administruar përgjimet telefonike midis administratorit dhe rojës në ditën e aksidentit kur u njoftua urdhri i pretenduar nga administratori që të mos punohej ditën e shtunë; (b) nuk e ka administruar/verifikuar siç duhet këtë dokument të pretenduar të nënshkruar nga viktima dhe punonjësit e tjerë, duke deklaruar se janë informuar që nuk duhet të punojnë, por kanë këmbëngulur të punojnë me nismën e tyre. Ekziston vetëm një faqe fletoreje me emra të shkruar me dorë të punëtorëve (vetëm emra, nuk ka firma), dhe data e shkruar me dorë, 16.12.2011. Së pari, kjo është një letër e thjeshtë që mund të jetë përpiluar në çdo kohë. Së dyti, ajo mban datën 16, ndërsa aksidenti i referuar ka ndodhur në datën 17. Së treti, është një listë e thjeshtë e emrave pa ndonjë përmbajtje tjetër. Me kusht që dokumenti i nënshkruar nga dita e aksidentit të ekzistonte, duhet të ishte administruar dhe më pas t'i nënshtrohej ekspertizës për të verifikuar nëse ajo ishte nënshkruar vërtet nga viktima. Edhe në këtë rast, kjo nuk do të thotë se punonjësit thjesht u futën në minierë me iniciativën e tyre, por vetëm se kompania do të kishte marrë paraprakisht një deklaratë vullnetare prej tyre përpara se t'i shfrytëzonte për punë të shtunën. Prokurori e bazoi vendimin e tij vetëm në fjalë, në vend të provave.

126.3 Nga dokumentet e dosjes duket se viktima ishte regjistruar për të punuar me kompaninë vetëm për një muaj, që korrespondon me muajin përpara aksidentit. Kur ai u shfaq për të punuar dhe u lëndua deri në vdekje, më 17.12.2011, nuk kishte asnjë kontratë me kompaninë dhe asnjë sigurim. Ky fakt duket se është injoruar nga ekspertët teknikë dhe prokurori.

126.4 Hetimi i njësisë teknike dhe i punonjësve, i rregulloreve dhe i udhëzimeve të shoqërisë është i cekët.

126.5 Edhe pse janë bërë dy aktekspertime teknike, duke fajësuar viktimën, ata janë të cekët: nuk marrin parasysh provat relevante dhe nuk arrijnë të krijojnë lidhje logjike shkasore të besueshme ndërmjet veprimit/mosveprimit të viktimës dhe ngjarjes së ndodhur.

127. Nga sa më lart, në lidhje me këtë procedim, arrihet në konkluzionin se:

127.1 Vendimi i prokurorit për mbylljen e procedimit penal nuk është i arsyetuar siç duhet dhe nuk përfshin të gjitha elementet dhe përmbajtjen e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e një çështjeje penale. Rrethanat faktike, lidhur me dinamikën e ngjarjes, provat që mbështesin përfundimin dhe analizën e provave të tilla nuk janë përshkruan siç duhet;

127.2 Vendimi është marrë në bazë të rrethanave të verifikuara vetëm pjesërisht dhe pa kryer hetime të plota që do të çonin në një konkluzion të saktë mbi ekzistencën e një vepre penale – qoftë ajo që parashihet me 289 të Kodit Penal, ose të ndonjë vepre tjetër penale;

127.3 Prokurori duhet të kishte kryer një hetim të plotë para se të vendoste për mbylljen e procedimit penal. Nëse, siç duket nga vendimi i tij, ai ishte i bindur se individë të paautorizuar hynë në ambientet e kompanisë për të punuar me iniciativën e tyre, ndërkohë që ata ishin paralajmëruar qartë që të mos e bënin këtë gjë, ai duhet të kishte filluar procedimin penal kundër këtyre individëve. Përndryshe, nga dokumentet e administruara në këtë dosje, ai duhet të kishte hetuar më tej këtë çështje dhe nuk duhet të qëndronte i verbër ndaj shfrytëzimit të paligjshëm të vërejtur.

128. Komisioni vlerëson, se për sa më lart – lidhur me veprimet, mosveprimet dhe konkluzionet e subjektit të rivlerësimit, evidenton një përputhje të këtyre fakteve me dyshimet e ngritura nga informacionet e klasifikuara mbi një favorizim të shoqërive që operojnë në minierën e Bulqizës. Nga dokumentet e kësaj dosjeje janë konstatuar shumë fakte, rrethana, detaje dhe të dhëna që konfirmojnë informacionet e klasifikuara – me të cilat është njohur trupi gjyqësor, përgjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, lidhur me vendimin e pushimit në fjalë, vlen të theksohet mungesa e logjikës analitike dhe pabazueshmëria në fakte e motivimit të tij – në raport me akuzat. Nga një vlerësim tërësor i kësaj dosjeje, nuk duket i mjaftueshëm argumentimi që i bën subjekti vendimit të pushimit, duke u bazuar vetëm tek aktet e ekspertimit, ku në njërin prej tyre pohohet se: “[...] aksidenti ka ndodhur nga mosrespekimi i rregullave të teknikës së sigurimit në punë nga i aksidentuari dhe punëtorët shoqërues të tij [...]”. Këtu duhet theksuar fakti që aktet e ekspertimit kanë një funksion ndihmës, por jo detyrues për magjistratin, pasi vlerësimet dhe konkluzionet e ekspertëve duhet gjithsesi t’i nënshtrohen logjikës argumentuese dhe vlerësimit, në tërësi dhe në harmoni të të gjitha informacioneve dhe dokumenteve në dispozicion.

129. Ndërkohë që, në vendimin e pushimit në fjalë, veç të tjerash, subjekti shprehet në mënyrë kontradiktore, duke specifikuar se “[...] rezulton se në ardhjen e aksidentit me pasojë vdekjen e shtetasit B. J. nuk ka pasur shkelje të rregullave të teknikës së sigurimit [...] veç të ndjerit²⁹ dhe se ky aksident ka ndodhur si rezultat i shkeljes së këtyre rregullave nga vetë i ndjeri [...]”.

²⁹ Ndërkohë që në aktin e ekspertimit, datë 30.12.2011, përcaktohet se: “[...] aksidenti ka ndodhur nga mosrespekimi i rregullave të teknikës së sigurimit në punë nga i aksidentuari dhe punëtorët shoqërues të tij [...]”.

Gjithashtu, në vendim citohet disa herë fakti që në ditën që ka ndodhur aksidenti vdekjeprurës, viktimia nuk duhej që kishte shkuar në punë, dhe as kolegët e tij, sipas urdhrin të administratorëve të kompanisë; nuk duhet të kishin punuar të shtunave dhe të dielave, por ata kishin dalë në punë me iniciativën e tyre.

130. Por, nga aktet e dosjes nuk rezulton e provuar që aksidenti të ketë ndodhur në një zonë ku viktimia nuk duhej të kishte akses, përkundrazi, ai është mbuluar nga masa shkëmbore duke punuar, pikërisht në frontin e punës – siç ka pohuar njëri nga dëshmitarët, (koleg i tij) që punonte bashkë me të atë ditë. Rrjedhimisht, kjo dinamikë eidenton faktin që në frontin e punës ka munguar siguria teknike në nivel të mjaftueshëm për të evituar aksidentet e këtij lloji. Nga hetimet nuk është provuar e kundërta – prezenca e sigurisë maksimale në frontin e punës (qoftë edhe në ditët apo javët *post factum*) – që mund të shkarkonte nga përgjegjësia punëdhënësin. Gjithashtu, një element sigurie teknike mund të konsiderohet edhe marrja e masave konkrete dhe efikase për mos mundësimin fizik të futjes së personave të paautorizuar në brendësi të galerisë nr. ***. Nëse nuk lejohej puna të shtunën dhe të dielën – siç kanë pretenduar punëdhënësit – atëherë duhej të ishin marrë masa për bllokimin fizik të kësaj galerie. Përveç kësaj, arsyetimi në vendim i pasojës, me vajtjen në punë të viktimës ditën e shtunë, nuk justifikon mungesën e sigurisë teknike të mjaftueshme si shkak aksidenti, për sigurinë e të cilës kompania punëdhënëse ka pasur detyrim ligjor.

131. Argumentimi i vendimit të pushimit rezulton jo bindës, i paplotë dhe alogjik, pasi – edhe nëse do të konsiderohej i vërtetë versioni i urdhrin të punëdhënëseve se të shtunën dhe të dielën nuk duhej të punohej në minierë (përtej përgjegjësisë në këtë rast për mosmarrje masash për mbylljen e aksesit në galeri në ditët që nuk punohej) – nga momenti që dyshimet e Prokurorisë ngriheshin mbi mungesën e sigurisë teknike në punë (në minierën e Bulqizës, që përbënte edhe objektin e hetimit), përgjatë hetimit si dhe në vendimin e pushimit, subjekti minimalisht duhej të kishte qartësuar, analizuar dhe argumentuar, mbi prova konkrete, se atje (në vendin e punës) nga e hëna deri të premtën ekzistonin masa sigurie shtesë që plotësonin të gjitha parametrat tekniko-ligjore, ndërsa të shtunën (pas disa orësh) dhe të dielën këto masa sigurie hiqeshin/çmontoheshin apo dobësoheshin. Kjo hipotezë duket qartësisht jo realiste dhe as nuk do të ishte ekonomikisht me interes për shoqëritë e shfrytëzimit të nëntokës, pasi një investim i bërë mbi sigurinë, (nëse ekziston) i shtrin efektet e veta parandaluese të aksidenteve në një segment kohor afatmesëm apo afatgjatë, dhe jo vetëm për pesë ditë nga e hëna deri të premtën. Pra, argumenti i të punuarit në kundërshtim me urdhrin nuk duket se ka lidhje direkte me pasjen apo jo të sigurisë teknike brenda asaj galerie. Gjithashtu, duhet shtuar se në gjendjen faktike të frontit të punës, duket konkrete mundësia që aksidenti në fjalë, siç ndodhi të shtunën në punë e sipër, (për mungesë sigurie teknike), do të kishte ndodhur ditën e hënë të mëpasshme, pasi të ishte nisur puna (e autorizuar) dhe gërmimi – nëse punëtorët nuk do të ishin futur në galerinë nr. *** të shtunën (e ngjarjes) dhe të dielën.

132. Komisioni çmon se, përpos mangësive në veprimet hetimore, mungesa e shpjegimit/arsyetimit bindës nga subjekti – në vendimin e pushimit të datës 20.11.2012 – mbi ekzistencën e masave të sigurisë në standardet e kërkuara, gjatë ditëve të punës, përbën elementin thelbësor që të çon në pabazueshmërinë e këtij vendimi, pasi nuk janë paraqitur (dhe nuk duket se kishte) shkaqe konkrete ligjore për përjashtimin e ekzistencës së elementeve të veprës penale dhe rrjedhimisht, të përgjegjësisë së personave të dyshuar. Për rrjedhojë, së paku

kjo dosje duhej të ishte përcjellë për gjykim dhe, në rrjedhën e një procesi gjyqësor, do të mund të verifikohet dhe të qartësohet më mirë edhe pjesa e pazbardhur nga hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit.

133. Gjithashtu, vlerësohet jo bindës pozicionimi i mbrojtjes së subjektit të rivlerësimit, i shpjeguar në prapësimet e tij edhe në seancë dëgjimore, sipas të cilit vendimi i tij i pushimit *de quo* ishte bazuar në aktet e ekspertimit³⁰ dhe nuk ishte ankimuar nga trashëgimtarët e viktimës dhe kjo, sipas tij, tregonte se ishte i drejtë dhe i bazuar. Ky arsyetim nuk rezulton të ketë forcë argumentuese, sepse duke pasur parasysh rrethanat dhe kushtet socio-ekonomike, demotivuese dhe privuese, në të cilat ndodhen familjet e minatorëve, është e qartë vështirësia dhe pamundësia e tyre (intelektuale dhe financiare), për të pasur një akses (të suksesshëm) në sistemin aktual të drejtësisë – me qëllim mposhtjen dhe dënimin e punëdhënësit e tyre, nëpërmjet rrëzimit të vendimeve të tilla, qofshin ato pushimi apo mosfillimi. Gjithsesi, Komisioni konsideron se nuk mund të përdoret si parametër vlerësues i një vendimi, ankimimi ose jo i tij, nga pasardhësit e viktimës (në rastin konkret të një kryefamiljari që ka humbur jetën duke punuar në minierë), të cilët nuk posedojnë as njohuri juridike dhe as mundësi financiare për të paguar punën e ndonjë zyre ligjore – për më tepër që në atë periudhë (menjëherë pas një ndodhie tragjike në familje), ata nuk kanë pasur as qetësinë dhe as kthjelltësinë për të menduar mbi ecurinë e hetimeve në fjalë. Ndërsa prokuroria do të duhej të mbronte interesin publik dhe, në rastin konkret, me dërgimin e çështjes për gjykim, duke i hapur rrugë, në këtë mënyrë, edhe mundësisë për një përbushje të detyrimeve financiare në favor të trashëgimtarëve të viktimës, për humbje jete në vendin e punës, për mungesë të kushteve teknike të sigurisë fizike dhe shëndetësore të punëtorëve. Pretendimet e subjektit lidhur me mosankimin e vendimit nga trashëgimtarët ligjorë të viktimës, nuk e përjashton atë, si përfaqësues i organit të akuzës, nga përgjegjësia për të zbatuar drejt ligjin, në mbrojtje të interesit publik dhe, në rastin konkret, me dërgimin e çështjes për gjykim, duke i hapur rrugë, në këtë mënyrë, edhe mundësisë për një përbushje të detyrimeve financiare në favor të trashëgimtarëve të viktimës, për humbjen e jetës së të afërmit të tyre në vendin e punës – për mungesë të kushteve teknike të sigurisë fizike dhe shëndetësore të të punësuarve në minierë.

134. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se vendimi i pushimit në fjalë rezulton i pabazuar në fakte dhe i motivuar në mënyrë sipërfaqësore dhe i pa argumentuar mjaftueshëm. Procedimi, i konkluduar me këtë vendim pushimi jo bindës, evidenton një sërë problematikash, si: mangësi hetimore³¹; analizë jo objektive mbi faktet e dinamikës së aksidentit dhe lidhjes së tij shkak-pasojë me pasigurinë e frontit të punës në galerinë nr. 58; arsyetim të dobët dhe të pambështetur në prova; dyshime për favorizim të personave nën hetim – duke konfirmuar në këtë mënyrë edhe dyshimet e ngritura nga burimet konfidenciale dhe nga informacionet e klasifikuara – me pasojë cenimin e besimit të publikut tek figura e prokurorit/magjistratit.

Çështja nr. 2

³⁰ Aktet e ekspertimit kanë funksion ndihmës, por jo detyrues për magjistratin, pasi vlerësimet dhe konkluzionet e tyre duhet gjithsesi t'i nënshtrohen logjikës argumentuese dhe vlerësimit në tërësi dhe në harmoni të të gjitha informacioneve dhe dokumenteve në dispozicion.

³¹ Lidhur me mosbllokimin e hyrjes në galeri, si dhe me mosverifikimin e ekzistencës ose jo të parametrave të sigurimit fizik dhe shëndetësor të minatorëve – duke (mos)kryer edhe matjet e ndotjes së ajrit në thellësi të galerive.

Vendimi datë 12.5.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për mbylljen e procedimit penal nr. * të vitit 2012**

135. Prokuroria e Rrethit Dibër, në datën 25.4.2012, regjistroi procedimin penal nr. ***, në vijim të kallëzimit të policisë të datës 19.4.2012. Policia ka referuar vdekjen në punë të shtetasve N. H. dhe Q. Sh., të dy minatorë që punonin në tunelin që po shfrytëzohej nga subjekti ***. Regjistrimi i procedimit penal përfshinte regjistrimin e emrave të personave, të cilëve u ishte atribuar vepra penale, konkretisht emrat e administratorit R. B. dhe të drejtuesit teknik, F. M. Po kjo prokurori, në datën 20.11.2012 vendosi mbylljen e çështjes penale nr. *** të vitit 2012, sepse nuk përmbushen elementet e veprës penale “Shkelje të rregullave të sigurisë në punë”. I biri i njërit prej viktimave ka ankimuar këtë vendim. Prokuroria e Përgjithshme vendosi revokimin e vendimit për mbylljen e çështjes dhe sugjeroi vijimin e hetimeve, duke caktuar detyra konkrete. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, prokuroria vendosi sërish mbylljen e çështjes.

136. Djali i njërit prej viktimave iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke pretenduar se prokuroria e mbylli çështjen duke u mbështetur në akte – si, procesverbalet e udhëzimeve teknike dhe dokumente të tjera të administruara nga shoqëria – të fabrikua nga shoqëria me qëllim që t’i shmangej ndjekjes penale dhe se asnjëherë nuk është administruar dokumentacioni përkatës, si thirrjet telefonike, të cilat tregonin se viktimja ishte kontaktuar me telefon nga administratori i shoqërisë, duke i urdhëruar që të paraqitej në punë, pikërisht në ditën e aksidentit.

137. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. ***, datë 27.10.2016, arsyetoi se:

137.1 Vendimi i prokurorisë është bazuar në një hetimit të paplotë.

137.2 Prokuroria duhej të kishte administruar origjinalin e procesverbalit të udhëzimit teknik, të nënshkruar nga viktimja, në vend të kopjeve të paraqitura nga shoqëria dhe duhej të kishte verifikuar në rrugë shkencore nëse nënshkrimi ka qenë i viktimës.

137.3 Edhe pse detyra e mësipërme i ishte ngarkuar nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Dibrës nuk e zbatoi këtë detyrë.

137.4 Prokuroria duhet të identifikojë dhe të administrojë dokumentacionin origjinal dhe të mbështesë vendimet e saj vetëm mbi shkresat origjinale.

137.5 Baza për dhënien e vendimit për mbylljen e hetimeve ka qenë një akt ekspertimi teknik, sipas të cilit aksidenti ndodhi për faj të viktimave, pasi ata kanë hyrë në vendin e aksidentit pa pasur ndonjë udhëzim për një gjë të tillë. Ky përfundim u mor si i mirëqenë nga prokuroria, duke e përdorur atë si bazë për arsyetimin e vendimit, për mbylljen e çështjes, por të tilla përfundime nuk mbështeten në prova.

*137.6 Prokuroria duhej të kishte kryer këqyrje në terren pranë ***-së në lidhje me mënyrën se si mbahen procesverbalet e ndërprerjes së punimeve dhe ato të udhëzimeve teknike.*

138. Më pas, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka rrëzuar vendimin e prokurorisë për mbylljen e çështjes dhe urdhëroi vijimin e hetimeve. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.6.2018, vendosi të linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Ky vendim mori formë të prerë. Prokuroria e Përgjithshme informon se aktualisht janë duke u kryer hetime për këtë çështje.

139. Ky procedim mund të analizohet në funksion të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit Hysni Vata, pasi, edhe pse dosja, pas rikthimit është duke u hetuar (nga prokurorë të tjerë), vendimi i datës 12.5.2014, i Prokurorisë së Rrethit Dibër për të mbyllur procedimin penal nr. *** të vitit 2012, nuk është një çështje në shqyrtim, sipas pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke qenë se subjekti e ka shprehur përfundimisht qëndrimin e vet në vendimin që kishte marrë, i cili është vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e apelit. Në këtë drejtim, interpretues ka qenë edhe qëndrimi i mbajtur nga Kolegji i Apelit për çështje të ngjashme në vendimin nr. 7/2019.

140. Nga sa më lart, arrihet në konkluzionin se vendimi në fjalë, i marrë nga subjekti Hysni Vata, është marrë duke u bazuar në rrethana të verifikuara vetëm pjesërisht dhe pa kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, si dhe pa administruar prova të besueshme, të cilat do të çonin në nxjerrjen e një përfundimi të saktë në lidhje me ekzistencën e elementeve të veprës penale.

141. Edhe në këtë rast Komisioni u referohet konkluzioneve dhe arsyetimeve të përshkruara më lart, në lidhje me çështjen e mësipërme (procedimin penal nr. *** i vitit 2012), për sa i përket mangësive profesionale të subjektit, veprimeve dhe mosveprimeve të tij – në këtë rast të evidentuara edhe nga dy gjykata. Bazuar në sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se pikërisht për këto çështje, trupi gjykues ka parë informacione konfidenciale pranë organeve ligjzuese që i referohen favorizimit që subjekti i rivlerësimit ka kryer për personat nën hetim, trupi gjykues çmon se kjo lloj qasjeje në hetime, mangësitë profesionale hetimore të konstatuara, si dhe vendimmarrjet nga ana e subjektit, kanë çuar në cenimin e besimit të publikut ndaj figurës së prokurorit.

Çështja nr. 3

Vendimi i Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, datë 20.10.2014, për mosfillimin e procedimit penal pas materialit të kallëzimit penal nr. *, referuar nga policia e Bulqizës me anë të shkresës nr. ***, datë 24.9.2014**

142. Në datën 21.9.2014 policia e Bulqizës u njoftua se shtetasi F. Z. u plagos rëndë në punë në minierën e subjektit minerar “****” sh.p.k., Bulqizë. Kallëzimi penal nr. *** u referua nga policia në Prokurorinë e Rrethit Dibër, më 24.9.2014. Më 20.10.2014, prokurori Hysni Vata lëshoi një vendim për të mosfilluar procedimin penal në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale (*akti nuk është parashikuar me ligj si veprë penale ose kur është vërtetuar qartë se akti nuk ekziston*).

143. Konkluzioni i subjektit në vendimin për mosfillim të procedimit penal – është se ngjarja ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë/gabimeve të punonjësve të dëmtuar. Por, nuk ka asnjë arsyetim të mbështetur nga dëshmitë dhe provat për këtë konkluzion, por thjesht një deklaratë që një nga paragrafët e rregullores teknike të sigurisë parashikon që “*punonjësit nuk duhet të nënvlerësojnë rrezikun dhe nuk duhet të marrin iniciativë në bazë të aftësisë, njohurisë dhe kompetencës së tyre individuale*”.

144. Vendimi bazohet vetëm në dokumentet e paraqitura nga policia, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të arritur në një përfundim të tillë, për arsyet e mëposhtme:

144.1 Personi i dëmtuar nuk është marrë asnjëherë në pyetje;

144.2 Kontrata e punës ndërmjet personit të dëmtuar dhe shoqërisë nuk është administruar ndonjëherë;

144.3 Asnjë shef/administrator i shoqërisë nuk është marrë në pyetje;

144.4 Edhe pse raporti i ekspertizës teknike tregon se zona ku ka ndodhur aksidenti është brenda fushës së mbulimit të licencës së kompanisë, vetë licenca nuk është administruar.

144.5 Dy punonjës të tjerë të pranishëm në momentin e lëndimit u morën në pyetje dhe, sipas deklaratave të tyre, i dëmtuari po kryente thjesht detyrat e tij sipas udhëzimeve. Ata nuk tregojnë ndonjë veprim të pamatur të tij me iniciativën e vet.

145. Raporti i ekspertimit teknik i datës 26.9.2014, thjesht thotë se aksidenti ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së punonjësit (*[...] një grumbull shkëmbor ra mbi kokën e tij[...]*), i cili sipas rregullave të sigurimit teknik duhet të njohë gjendjen e vendit të punës dhe të kontrollojë me kujdes vendin e punës dhe nuk duhet të nënvlerësojë rrezikun apo dhe të ndërmarrë iniciativa mbi bazën e aftësive, njohurive dhe kompetencës së tij individuale. Kjo është një deklaratë e thjeshtë që nuk mbështetet nga dëshmi dhe nuk shpjegon shkakun midis veprimeve apo mosveprimeve të të dëmtuarit dhe rënies së shkëmbinjve mbi kokën e tij.

146. Për më tepër, ky pohim bie në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve, të cilët pretendojnë se:

146.1 Ata pastruan vendin e punës para fillimit të punës;

146.2 Puna po zhvillohej sipas porosisë/udhëzimit;

146.3 Puna ishte duke u mbikëqyrur nga supervizori dhe personi përgjegjës për udhëzimin periodik, i cili nuk ndërhyri për t'i treguar të dyshuarit se po bënte diçka të gabuar. Mbetet e pashpjegueshme se si i plagosuri ka nënvlerësuar rrezikun dhe çfarë veprimesh konkretisht ka ndërmarrë ai me iniciativën e vet. Akti i ekspertizës nuk bazohet në dëshmi dhe prova (madje as licenca e shoqërisë nuk është e bashkëngjitur si dokument i administruar). Nuk ka asnjë dokument shkresor që ekspertët të kenë bërë betimin dhe nuk janë bashkëngjitur licencat e ekspertëve.

147. Nga sa më lart, arrihet në këto konkluzione:

147.1 Vendimi i subjektit për të mosfilluar procedimin penal nuk rezulton të jetë i arsyetuar në mënyrë bindëse dhe nuk përfshin të gjitha elementet dhe përmbajtjen e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e çështjes. Rrethanat faktike se si ndodhi ngjarja dhe provat që mbështesin atë përfundim dhe analiza e provave, nuk janë të mjaftueshme dhe nuk janë përshkruar siç duhet.

147.2 Vendimi është bazuar në rrethana të vërtetuara pjesërisht dhe pa kryer hetime të plota që do të çonin në një konkluzion më të saktë dhe mbi ekzistencën e elementëve të veprës penale.

147.3 Subjekti ka munguar të urdhërojë kryerjen – siç duhej të ishte kryer – e një akti ekspertize teknike të plotë, për t'iu përgjigjur një sërë pyetjesh në mënyrë shteruese.

147.4 Vendimi i mosfillimit nuk përmban ndonjë shkak të mirëfilltë justifikues dhe argumentues, pasi neni 290 i Kodit të Procedurës Penale kërkon ekzistencën e dukshme të rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal – por nuk duket të ketë qenë kështu në këtë rast.

147.5 Nuk janë kryer hetime të plota, duke administruar dhe marrë në konsideratë më shumë prova. Personi i plagosur nuk është dëgjuar, por ai duhej të ishte marrë në pyetje. Gjithashtu, edhe raporti i ekspertizës teknike duhej t'i ishte nënshtruar pyetjeve të mëtejshme për të zbardhur plotësisht ngjarjen në fjalë.

147.6 Në momentin që subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk është verifikuar ekzistenca, përtej dyshimit të arsyeshëm, e ndonjë prej rrethanave që nuk lejojnë regjistrimin e procedimit penal, edhe për faktin se nuk ka pasur ndonjë akt të ekspertizës teknike dhe materialet e administruara në dosje, si dhe hapat e kryera hetimore nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar mbi kryerjen e një hetimi tërësor, të thelluar dhe gjithëpërfshirës. Për rrjedhojë, subjekti duhej të kishte regjistruar procedimin penal në fjalë dhe të hetonte mbi rastin.

148. Komisioni, për sa më lart, vlerëson se: vendimi i mosfillimit mbi këtë çështje nuk përmban një shkak sipas parashikimeve të dispozitave ligjore të sipërcituara; arsyetimi i tij rezulton të jetë i pabazuar dhe jo bindës; evidentohet moskryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore, të nevojshme, mbi fakte dhe rrethanat e ngjarjes objekt hetimi. Nisur nga këto konstatime, si dhe duke pasur në konsideratë informacionet konfidenciale të marra nga organet ligjzbatuese për favorizim të personit nën hetim nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje, trupi gjykues çmon se veprimet dhe mosveprimet e subjektit, si dhe vendimmarrja e tij, kanë cenuar besimin e publikut ndaj figurës së prokurorit/magjistratit dhe, rrjedhimisht, ndaj sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Çështja nr. 4

Vendimi i Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, datë 25.6.2015, për mosfillimin e procedimit penal pas kallëzimit penal nr. *, referuar nga policia e Bulqizës me anë të shkresës nr. ***, datë 4.5.2015**

149. Më 30.4.2015, policia e Bulqizës u njoftua se shtetasit B. P. dhe E. H., punonjës të minierës “***” sh.p.k., ***, u dëmtuan/plagosën në vendin e punës. Kallëzimi penal nr. *** i është referuar Prokurorisë së Rrethit Dibër, më 4.5.2015.

150. Më 25.6.2015, prokurori Hysni Vata ka nënshkruar një vendim për mosfillimin e procedimit penal në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale (*akti nuk është përcaktuar me ligj si veprë penale ose kur vërtetohet qartë se akti nuk ekziston*).

151. Konkluzionet e arritura nga subjekti – për të nxjerrë vendimin e tij për mosfillimin e procedimit penal – bazohej në faktin se ngjarja ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë/gabimeve të punonjësve të plagosur/dëmtuar. Në vendimin në fjalë rezulton të jetë bërë një përshkrim i thjeshtë në këtë drejtim, por nuk ka asnjë arsyetim për të hedhur dritë mbi çka çoi në një përfundim të tillë, si dhe asnjë shpjegim se çfarë gabimi kanë bërë punonjësit e plagosur. Gjithashtu, përfundimi nuk mbështetet nga dokumentacione provuese apo nga dëshmi mbi dinamikën e ngjarjes.

152. Prej momentit kur prokurori ka pranuar shkresën nga Policia Gjyqësore (**datë 4.5.2015**), deri në datën e vendimmarrjes së tij për mosfillimin e procedimit penal (**25.6.2015**), nuk rezulton të jetë ndërmarrë asnjë veprim hetimor nga prokurori i çështjes, z. Hysni Vata.

153. Rezulton se subjekti është mbështetur vetëm në aktet/dokumentet e ardhura nga Policia Gjyqësore për vendimmarrjen e tij. Nga analizimi i materialit të dosjes në fjalë konstatohet se Policia Gjyqësore ka dorëzuar në Prokurori këto dokumente: (a) njoftimin (dokumentin e informacionit, datë 1.5.2015) për veprën penale; (b) regjistrimin e inspektimit në terren dhe fotografitë përkatëse; (c) vendimet që urdhërojnë ekspertizën mjeko-ligjore dhe ekspertimin e

sigurisë teknike; (d) pyetur personat që kanë njohuri për veprën penale që përfshijnë marrjen në pyetje të pesë punonjësve, duke përfshirë vetëm një nga të dëmtuarit; (e) udhëzuesin periodik të punonjësve; (f) urdhrat dhe programet e punës; (g) lejen zhvillimore; (h) raportin mjeko-ligjor vetëm për njërin nga personat e dëmtuar (B. P.). Lidhur me personin tjetër të dëmtuar (E. H.), rezulton shënimi se ai nuk u paraqit dhe as nuk u mor në pyetje, pasi nuk shihej e nevojshme.

154. Vlerësohet se dokumentet e sipërcituara nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar në një vendim mosfillimi të procedimit penal, për arsytet e mëposhtme:

154.1 Raporti i ekspertimit të sigurisë teknike nuk është administruar asnjëherë. Sipas shënimeve të policisë në kryerjen e ekspertizës të sigurisë teknike, raporti i ekspertizës duhet të ishte përgjigjur në disa nga pyetjet për thelbin e ngjarjes/hetimeve të mundshme për shkeljen e rregullave të sigurisë në punë, si: (a) masat teknike të sigurisë të marra nga kompania për sigurimin e kushteve teknike në lidhje me shkatërrimin e objekteve në vendin e aksidentit; (b) nëse ka ndonjë shkelje të rregullave të sigurisë teknike në këtë ngjarje specifike dhe nëse po, cilat rregulla dhe nga kush; (c) dëmtimi dhe përgjegjësia përkatëse e të dëmtuarit;

154.2 Ekspertët nuk u thirrën kurrë – ekspertiza dhe përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve nuk u siguruan asnjëherë. Nuk ka asnjë shpjegim/arsyetim mbi vendimin e prokurorit për të mosfilluar procedimin përse kjo nuk ishte e nevojshme dhe si mund t'i përgjigjeshin pyetjeve të mësipërme nga vetë prokurori. Në vend të kësaj, vendimi i tij për të mosfilluar procedimin penal nuk i përgjigjet këtyre pyetjeve, por thjesht thekson se ishte papërgjegjshmëria e personave të dëmtuar që çuan në aksident;

154.3 Ndryshe nga sa shprehet prokuroria në vendimin e saj për mosfillimin e procedimit, punonjësit e marrë në pyetje nga policia nuk kanë deklaruar se aksidenti ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë së personit të dëmtuar (B. P.);

154.4 Për më tepër, një nga personat e plagosur, pikërisht B. P., nuk u mor në pyetje asnjëherë. Kjo e bën raportin mjekësor (jo akt ekspertize) për këtë person të dyshimtë, duke pasur parasysh se ajo konsiston në një deklaratë të thjeshtë, mbi llojin e lëndimit pa shpjegime dhe prova. Në hetime duhet të ishte përfshirë edhe dëgjimi mbi dinamikën e ngjarjeve i personit tjetër të plagosur;

154.5 Nga dokumentet e administruara nga Policia Gjyqësore rezulton një urdher për shtetasin B. P., për të punuar në shkatërrimin e objektit ku ai, më pas u plagos, kështu që ai nuk ka qenë duke vepruar përtej kompetencave së tij.

Nga sa më lart arrihet në konkluzionet që vijojnë.

155. Vendimi i prokurorit për të mosfilluar procedimin penal nuk është arsyetuar mjaftueshëm dhe qartë, si dhe nuk përfshin të gjitha elementet dhe përmbajtjen e një vendimi, konkludues të hetimeve mbi një vepër të mundshme penale. Nuk rezulton të jenë përshkruar rrethanat faktike mbi dinamikën e ngjarjes, provat mbi të cilat mbështetet vendimi i mosfillimit dhe analiza e tyre.

156. Në momentin që subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk është verifikuar ekzistenca, përtej dyshimit të arsyeshëm, e ndonjë prej rrethanave që nuk lejojnë regjistrimin e procedimit penal, edhe për faktin se nuk ka pasur ndonjë akt të ekspertizës teknike dhe materialet e administruara në dosje, si dhe hapat hetimore të kryera nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar mbi kryerjen e një hetimi tërësor, të thelluar dhe gjithëpërfshirës. Për

rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit duhej të kishte regjistruar procedimin penal në fjalë dhe të hetonte mbi rastin.

157. Komisioni, edhe në këtë rast, konstaton: (i) mungesën e kryerjes së hetimeve të plota dhe gjithëpërfshirëse; (ii) hetime të nxituara pa kryer të gjitha hapat hetimore (të planifikuar dhe urdhëruar); si dhe (iii) pagabueshmërinë e vendimmarrjes për mosfillim të procedimit penal, për shkak të mosadministrimit në dosje të aktit të ekspertimit ndaj të dëmtuarit Enver Hysa, në mospërfillje të vendimit, datë 30.4.2015, (i parevokuar/çfuqizuar) të vetë prokurorisë në fjalë, me të cilin ishte caktuar eksperti, duke i kërkuar kryerjen e ekspertimit mbi dëmtimet e këtij shtetasi. Trupi gjykues çmon se mangësitë e konstatuara në hetimin e kësaj çështjeje, për të cilën gjithashtu ka pasur informacione të klasifikuara, në çdo rast përbëjnë në vetvete shkak për humbjen e besimit të publikut ndaj sistemit të drejtësisë.

Çështja nr. 5

Vendimi datë 12.2.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për mosfillimin e procedimit penal pas kallëzimit penal nr. *, referuar nga policia e Bulqizës me anë të shkresës nr. ***, datë 30.1.2015**

158. Më 28.1.2015, policia e Bulqizës u njoftua se shtetasi RR. H. ishte plagosur në punë në minierën e subjektit minerar “****” sh.p.k., Bulqizë. Kallëzimi penal nr. *** u dërgua në Prokurorinë e Bulqizës më 30.1.2015.

159. Më 12.2.2015, prokurori Hysni Vata ka nënshkruar një vendim për mosfillim e procedimit penal – në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale (*akti nuk është parashikuar me ligj si vepër penale ose kur vërtetohet qartë se akti nuk ekziston*).

160. Konkluzioni i subjektit ka qenë se ngjarja e plagosjes ka ndodhur si pasojë e një gabimi njerëzor dhe e papërgjegjshmërisë së personit të dëmtuar. Nuk ka asnjë arsyetim të mbështetur nga prova konkrete, por konsiston në pohimin e thjeshtë se personat e pyetur (kolegët e të dëmtuarit) e kanë thënë këtë.

161. Vendimi bazohet vetëm në dokumentet e paraqitura nga policia, të cilat konsiderohen të pamjaftueshme për të arritur në një përfundim të tillë, për arsyet e mëposhtme:

161.1 Raporti i ekspertimit për sigurinë teknike nuk është administruar asnjëherë. Sipas procesverbalit të policisë, datë 28.1.2015, mbi kryerjen e ekspertimit të sigurisë teknike, raporti i ekspertimit duhet të ishte përgjigjur në disa nga pyetjet për thelbin e ngjarjes/hetimeve të mundshme për “Shkeljen e rregullave të sigurisë në punë”, si: (a) nëse vendi i aksidentit është brenda fushës së licencimit së kompanisë; (b) masat e sigurisë teknike të ndërmarra nga kompania; (c) nëse ka ndonjë shkelje të rregullave të sigurisë teknike në ngjarjen specifike, nga kush dhe personat përgjegjës për shkeljen; (d) shkaqet e aksidentit dhe nëse i dëmtuari ka pasur ndonjë përgjegjësi për ngjarjen; (e) nëse mbajtësi i licencës ka ndonjë përgjegjësi;

161.2 Ekspertët nuk u thirrën kurrë – ekspertiza dhe përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve nuk u siguruan asnjëherë. Nuk ka asnjë shpjegim/arsyetim mbi vendimin e prokurorit për të mos filluar procedimin, pse kjo nuk u pa e nevojshme dhe si mund t'i përgjigjej pyetjeve të mësipërme vetë prokurori. Në vend të kësaj, vendimi i tij për të mos filluar procedimin nuk i përgjigjet pyetjeve të tilla, por thjesht thekson se ishte pakujdesia e personit të dëmtuar që ka çuar në aksident;

161.3 Personi i dëmtuar nuk është marrë asnjëherë në pyetje, as nga prokuroria dhe as është vizituar e dëgjuar nga mjeku;

161.4 Edhe pse ekziston një raport i ekspertimit mjekësor – i kryer mbi kartelën klinike - ai thjesht deklaron një përfundim pa iu referuar provave, gjë që bëhet e diskutueshme duke pasur parasysh se personi i dëmtuar nuk është vizituar/ekzaminuar dhe as është marrë në pyetje. Gjithsesi, ky akt ekspertimi mjeko-ligjor, i datës 6.2.2015, nuk shprehet mbi shkaqet e mundshme të dëmtimit, në kuptimin e përgjegjësisë;

161.5 Nuk është administruar asnjë kontratë në lidhje me marrëdhënien e punësimit të personit të dëmtuar me shoqërinë që administronte dhe shfrytëzonte galerinë ku ndodhi aksidenti;

161.6 Vendimi është bazuar mbi deklaratimet e drejtuesve (teknikë) të shoqërisë, për të cilën punonte i plagosuri (që nuk është marrë në pyetje). Kjo rrethanë e rëndon pozitën e subjektit të rivlerësimit;

161.7 Ndryshe nga sa shprehet prokuroria në vendimin për të mos filluar procedimin penal, nuk është e vërtetë që të gjithë personat e marrë në pyetje kanë fajësuar të dëmtuarit. Vlen të përmendet se shumica e individëve të marrë në pyetje arritën në vendin e aksidentit sapo ndodhi ngjarja. Ndërsa supervizori dhe kolegët pohojnë se personi i dëmtuar RR. H., në momentin e aksidentit, ishte duke qëndruar aty sipas një urdhri të supervizorit, duke bërë pikërisht atë që i ishte thënë të bënte dhe aty ku i ishte thënë.

Nga sa më lart arrihet në konkluzionet e mëposhtme.

162. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal, marrë nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton që të jetë arsyetuar mjaftueshëm, në të cilin nuk përfshihen të gjitha elementet dhe përmbajtja e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e çështjes. Rrethanat faktike se si ndodhi ngjarja, provat që e mbështesin atë përfundim dhe analiza e provave, nuk janë përshkruar siç duhet.

163. Vendimi është marrë në bazë të rrethanave të vërtetuara pjesërisht dhe pa kryer hetime të plota që do të çonin në një konkluzion më të saktë mbi ekzistencën e elementeve të veprës penale. Nuk është kryer një aktekspertizë teknike dhe ky fakt evidenton mangësinë në hetime dhe vendimmarrjen e nxituar dhe të pabazuar në prova të subjektit. Neni 290 i Kodit të Procedurës Penale kërkon ekzistencën e dukshme të rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, gjë e cila nuk është e vërtetuar as në dosje dhe as në vendimin e subjektit, si në këtë rast, ashtu edhe në raste të tjera.

164. Komisioni, nga një analizë e dokumentacionit të dosjes në fjalë, vlerëson se: vendimi i mosfillimit mbi këtë çështje nuk përmban një shkak, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore të sipërcituara; arsyetimi i tij rezulton të jetë i pabazuar dhe jo bindës; evidentohet moskryerja e veprimeve hetimore, të domosdoshme, mbi faktet dhe rrethanat e ngjarjes objekt hetimi – si, mungesa e ekspertizës teknike mbi shkaqet e aksidentit plagosës. Këto konkluzione – të ngjashme me ato të arritura mbi çështjet e tjera të analizuara më lart – evidentojnë disa mangësi profesionale kronike të subjektit të rivlerësimit, përgjatë hetimeve të kryera prej tij, lidhur me përgjegjësitë penale për mungesën e sigurisë teknike në punë, pra galerive të minierës së Bulqizës, si dhe një *modus operandi* sipërfaqësore dhe të papërshtatshme me funksionin e tij – nga momenti që rezulton në mënyrë të përsëritur dhe konstante mospërmbushja e detyrave (hetimeve) prej tij, në mënyrën e duhur, qoftë në funksionin e prokurorit, po ashtu edhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë. Nga ana tjetër, trupi gjykues çmon se dyshimet dhe informacionet e klasifikuara – të njohura nga trupi gjykues – që referojnë edhe mbi

favorizimeve që subjekti i rivlerësimit ka kryer në favor të personave nën hetim, pikërisht për këto lloj çështjesh – të hetuara prej tij, përforcojnë bindjen se veprimet dhe mosveprimet gjatë procesit të hetimit, si dhe kjo vendimmarrje e subjektit, kanë cenuar besimin e publikut ndaj figurës së prokurorit dhe, rrjedhimisht, ndaj sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Çështja nr. 6

Vendim i datës 15.3.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për mosfillimin e procedimit penal, për kallëzimin penal nr. *, datë 25.2.2015**

165. Në datën 20.2.2015, policia e Bulqizës u njoftua se shtetasja M. I. ishte plagosur në punë në minierën e subjektit “****” sh.p.k., Bulqizë. Kallëzimi penal nr. *** i referohej Prokurorisë Rrethit Bulqizë në datën 23.2.2015.

166. Në datën 15.3.2015, subjekti i rivlerësimit vendosi për mosfillim të procedimit penal në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale (*fakti nuk parashikohet me ligj si veprë penale, ose kur provohet qartazi se fakti nuk ekziston*).

167. Konkluzioni i arritur nga subjekti konsiston në faktin se gjithçka që ka ndodhur ka qenë një aksident, pa asnjë analizë apo ndonjë arsyetim të mbështetur me prova.

168. Rezulton se vendimi i mosfillimit, në fjalë, është i bazuar në pohimet e administratorit të shoqërisë për të cilën punonte e plagosura dhe në dokumentacionin e paraqitur fillimisht nga Policia Gjyqësore, i cili konsiderohet i pamjaftueshëm për të arritur në një përfundim të tillë. Vijnë arsyet për të cilat vendimi i mosfillimit vlerësohet i pabazuar.

169. Nuk rezulton të jetë administruar në dosje, përpara se të vendosej mosfillimi, asnjë akt ekspertimi teknik për sigurinë në vendin e punës ku ndodhi aksidenti. Sipas urdhrin të policisë së datës 20.2.2015, për kryerjen e ekspertizës teknike mbi sigurinë, akti i ekspertimit duhej të kishte ofruar përgjigje për disa pyetje që i përkasin thelbit të ngjarjes/hetimit të mundshëm për “Shkeljen e rregullores së sigurisë në punë”, si: (a) nëse vendi i aksidentit përfshihet në objektin e licencës së shoqërisë; (b) nëse ka ndonjë shkelje të rregullave të sigurisë teknike në ngjarjen konkrete; (c) cila është ajo, si dhe personat përgjegjës për shkeljen; (d) shkakun e aksidentit dhe nëse i plagosuri ka ndonjë përgjegjësi për ngjarjen; (e) nëse mbajtësi i licencës ka ndonjë përgjegjësi. Por, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pa e pritur ekspertizën e kërkuar. Vendimi në fjalë është i datës 15.3.2015, ndërsa akti i ekspertimit tekniko-minerar (i kërkuar nga prokuroria), rezulton të jetë përpiluar në datën 4.5.2015. Ky fakt, përpos evidentimit të mangësisë profesionale lidhur me vendimmarrjen e mosfillimit të nxituar dhe të gabuar, nxjerr në pah një kontradiktë të veprimeve konkrete të subjektit me shpjegimet e tij, ku mëshon mbi faktin se vendimet e tij janë marrë duke u bazuar mbi ekspertizat teknike, duke pohuar: “[...] Në rastet kur një organ procedues i drejtohet ekspertit, për të përcaktuar zgjidhjen e drejtë të një çështjeje, besoj se është mendimi i ekspertit që prevalon dhe ai që përcakton edhe zgjidhjen e saj [...]”. Në këtë rast subjekti ka vepruar në sens të kundërt, duke mos nxitur dhe pritur aktin e ekspertizës, por duke vendosur vetë mbi informacionet (e pavërteta, si në vijim) e dhëna nga administratori i shoqërisë objekt kallëzimi – në konflikt të hapur interesi.

170. Në vendimin e mosfillimit të datës **15.3.2015**, subjekti shprehet se nga prokuroria është marrë një vendim për kryerjen e ekspertizës teknike, por ai (subjekti) ishte informuar nga administratori i shoqërisë (në verifikim) se ekspertët e RISHM-së (Reparti i Inspektimit dhe

Shpëtimit të Minierave) nuk kryejnë ekspertiza për raste të lehta. Prokuroria nuk ka administruar asnjë shkresë zyrtare të lëshuar nga RISHM, në të cilën të deklarohet një gjë e tillë. Kështu që, baza për vendimin e marrë nga z. Hysni Vata për të vijuar me mbylljen e çështjes pa pritur raportin e ekspertëve, nuk rezulton të jetë e bazuar as në ligj, as në logjikë dhe as në procedurë, por vetëm në thëniet e administratorit të shoqërisë (të përgënjeshtuara nga faktet), pasi dosja hetimore e administruar nga ONM-ja, përmban një akt ekspertimi teknik, që mban datën **4.5.2015** – pra, që është më shumë se një muaj e gjysmë, pasi subjekti i rivlerësimit kishte vendosur për mosfillimin e procedimit penal.

171. Gjithashtu, rezulton se personi i plagosur nuk është marrë asnjëherë në pyetje. Një gjë e tillë vë në dyshim ekspertizën mjekësore (e cila përbëhet nga një konkluzion i thjeshtë, pa asnjë shpjegim dhe pa prova), si dhe versionin e ngjarjeve të dhënë nga administratori i shoqërisë (në konflikt interesi), si dhe mbi përcaktimin se ky ka qenë një rast i lehtë. Ndërkohë që vendimi i mosfillimit i është njoftuar të plagosurës vetëm në datën **6.5.2015**.

Nga sa më lart vlerësohet:

172. Vendimi i analizuar mbi mosfillimin e procedimit penal nuk është i arsyetuar dhe nuk përfshin të gjitha elementet dhe përmbajtjen e një vendimi që zgjidh çështjen. Nuk janë argumentuar rrethanat e faktit si ka ndodhur ngjarja, provat që mbështesin konkluzionin e arritur nga subjekti dhe nuk është kryer një analizë e provave. Nuk kuptohet se si nuk mund të ketë përgjegjësi për mosmarrjen e masave paraprake për të ndaluar mbërritjen e gurëve nga shpati i malit në shpinën e një punëtoreje që gjendet në ambientet ku ushtrohet aktiviteti i shoqërisë, duke kryer detyrat që i janë përcaktuar nga punëdhënësi (nëse versioni i dhënë është real).

173. Subjekti ka vendosur duke u bazuar në rrethana të paverifikuara nga ekspertiza teknike në terren dhe pa u kryer më parë një hetim i plotë dhe i gjithanshëm, që do të çonte në nxjerrjen e një përfundimi më të saktë në lidhje me ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale të dyshuar. Subjekti nuk ka pritur kryerjen dhe administrimin e aktit të ekspertimit teknik, ndonëse ky veprim hetimor ishte urdhëruar nga vetë prokuroria. Subjekti nuk ka evidentuar/përshkruar ekzistencën e asnjë prej kushteve të parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit, duhet të ekzistojnë qartësisht rrethanat që nuk lejojnë nisjen e procedimit penal. Në këtë rast, nuk rezulton të ketë apo të jenë cituar nga subjekti rrethana të tilla.

174. Fakti që prokurori u mbështet në thëniet e administratorit të shoqërisë, se RISHM-ja nuk kryen ekspertiza në raste të tilla, si dhe përdorimi i thënieve të tilla në arsyetim të vendimit të mosfillimit, nuk mbështetet në asnjë dispozitë procedurale/logjike/ligjore. Gjithashtu, ky fakt përbën një qëndrim të anshëm (pasi në vend që të verifikoheshin në mënyrë të paanshme të gjitha informacionet dhe provat, veprohet mbi pohimet e personit objekt kallëzimi/verifikimi) dhe favorizim i dukshëm i shoqërisë, ndaj të cilës subjekti duhej të kishte regjistruar procedimin penal.

175. Ndonëse në një aktekspertimi, të lëshuar më shumë se dy muaj pas vendimit, thuhet se ngjarja ka qenë aksidentale, në momentin që prokurori vendosi të mosfillonte procedim penal, ekzistenca e rrethanave që nuk lejojnë regjistrim procedimi penal nuk ka qenë verifikuar përtej dyshimit të arsyeshëm, pasi nuk ka pasur ende aktekspertimi teknik dhe aktet e dosjes ishin të

pamjaftueshme për të arritur në një përfundim pa kryer hetime të mëtejshme, të plota dhe të gjithanshme.

176. Gjithashtu, është konstatuar një fakt anormal që nuk përputhet me logjikën e administrimit të dosjes, me normalitetin e kryerjes së veprimeve hetimore dhe të njoftimeve nga prokuroria. Ky fakt konsiston në vonesën e kryerjes së njoftimit të vendimit të mosfillimit *de quo*, pasi në vend që të bëhej menjëherë njoftimi i këtij vendimi te personi i plagosur, ky veprim u vonua deri sa mbërriti në prokurori akti i ekspertimit – i cili nuk është marrë në konsideratë në vendimmarrjen e subjektit, pasi asokohe ishte ende inekzistent – për t’u njoftuar menjëherë pas mbërritjes së tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

177. Subjekti i rivlerësimit, gjatë mbrojtjes së tij në seancën dëgjimore, si dhe në parashtrimet dhe shpjegimet e paraqitura me shkrim, ka shpjeguar se ka kryer gjithmonë funksionin e tij me ndershmëri dhe profesionalizëm, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore, duke hedhur poshtë konkluzionet e arritura nga DSIK-ja. Gjithashtu, ka sqaruar mbi hetimet e kryera dhe vendimmarrjet e tij lidhur me dosjet e përshkruara në rezultatet e hetimit të Komisionit, përfshirë edhe gjetjet e ONM-së. Sipas subjektit të rivlerësimit, në të gjitha rastet e përmendura, hetimet kanë qenë të plota dhe vendimet e tij janë marrë në mbështetje të dokumentacionit në dosjet përkatëse dhe të ligjit. Për sa u takon dosjeve që lidhen me hetimet e kryera nga subjekti lidhur me aksidentet e ndodhura në minierën e Bulqizës – mbi ekzistencën e mundshme të elementeve të veprës penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal – subjekti, veç të tjerash, ka pohuar se ai “[...] në çdo rast janë kryer gjitha veprimet e duhura verifikuese dhe hetimore, përfshirë këtu edhe aktekspertimet tekniko-minerare, me grup ekspertësh, edhe të përsëritura nga përmbajtja e të cilave është përcaktuar edhe vendimmarrja e subjektit për zgjidhjen e çështjes [...]”

Vlerësimi i Komisionit

178. Nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit mbi aftësitë profesionale, trupi gjykues çmon se faktet, rrethanat, veprimet, mosveprimet e subjektit, të dhënat e nxjerra nga disa prej dosjeve të studiuara nga Komisioni, ato të përcjella nga ONM-ja, si dhe konstatimet dhe vlerësimet e lartpërmendura lidhur me mangësitë e veprimeve hetimore dhe me anomalitë e *modus operandi* të subjektit, përbëjnë qëndrime që bien ndesh me parashikimet procedurale. Këto shkelje kanë rezultuar të një rëndësie të veçantë dhe me influencë mbi vendimmarrjet e subjektit, pasi kanë çuar në mënyrë të përsëritur në mosfillim apo në mbyllje hetimesh të paplota – jo në përputhje me rrethanat dhe faktet konkrete, apo me dispozitat ligjore, të cilat përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar mbi papërshtatshmërinë profesionale të z. Hysni Vata në aplikim të pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

179. Trupi gjykues çmon gjithashtu se, nga vlerësimi tërësor i të gjitha të problematikave të pasqyruara në lidhje me të tria kriteret, ndër të cilat përmendim: deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme në ILDKPKI; mosdeklarimin i shkëmbimit të apartamentit; dyshime të arsyeshme mbi integritetin e figurës, të ngritura nga organet ligjzbatuese dhe të konfirmuara

nga informacionet me të cilat janë njohur anëtarët e trupit gjykues; mangësitë profesionale të përsëritura dhe dyshime të arsyeshme mbi favorizime të personave nën hetim, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për cenimin e besimit të publikut në figurën e prokurorit dhe, më gjerësisht, në sistemin e drejtësisë, dhe për rrjedhojë në rastin konkret duhet të aplikohet edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

180. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin:

- i. Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme dhe ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**
- ii. Në lidhje me kontrollin e figurës, në mungesë të provueshmërisë së plotë të dyshimeve të arsyeshme të ngritura, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas gurmës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi, për sa i përket rivlerësimit të figurës, trupi gjykues nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet dhe elementet – të administruara në nivel të dhënash dhe/ose dyshimesh të arsyeshme – në dispozicion për të konkluduar ndryshe dhe, për rrjedhojë, e konsideron subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**
- iii. Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura, anomali dhe shkelje procedurale, të cilat sipas parashikimit të pikës 4, të nenit E, nuk mund të korrigjohen nëpërmjet programit njëvjeçar të trajnimit. Si rrjedhim, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas gurmës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 4, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**
- iv. Nga vlerësimi tërësor dhe, kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

181. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata, me funksion prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të

germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata, me funksion prokuror\drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 9.9.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes Shuli
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Pamela Qirko
Anëtare

Anisa Duka
Sekretare gjyqësore